

MASKULINITETI HEGJEMONIK

Rimendimi i konceptit

Nga: Raewyn Connell dhe James W. Messerschmidt

Përktheu: Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist

Koncepti i maskulinitetit hegjemonik ka pasur ndikim në studimet gjinore në shumë fusha akademike por në të njëjtën kohë ka marë edhe kritika serioze. Autorët/et identifikojnë gjenezën e këtij koncepti në një sërë ideshë përgjatë fillimit të viteve 80-ta dhe identifikojnë mënyrat se si ai është aplikuar në kohën kur hulumtimet mbi burrat dhe maskulinitetin filluan të marrin hov. Duke vlerësuar kritikën kryesore, autorët/et mbrojnë konceptin themelor të maskulinitetit i cili në shumicën e përdorimeve për qëllime hulumtuese nuk është as konkret apo esencialist. Sidoqoftë, kritika mbi karakteristikat e modeleve gjinore dhe tipologjive fikse është me vend. Trajtimi i subjektit në hulumtimet mbi maskulinitetin hegjemonik mund të përmisohet tutje duke përdorur modelet psikologjike të krijuara rishtazi, gjithësesi duhet pasur parasysh kufijtë e fleksibilitetit diskursiv. Koncepti i maskulinitetit hegjemonik nuk mund të barazohet në një model të riprodhimit shoqëror, ne duhet t'i njohim përpjekjet shoqërore në të cilat maskulinitetet e nënshtruara i ndikojnë në format dominante. Në fund, autorët/et rishqyrtojnë atë që veç se është konfirmuar nga artikulet e mëparshme (idenë e maskuliniteteve të shumëta, konceptin e hegjemonisë dhe insistimin në nevojën për ndryshim) dhe atë që duhet injoruar – trajtimin njëdimensional të hierarkisë dhe koncepteve karakteristike të gjinisë. Autorët/et propozojnë një riformulim të konceptit në katër fusha: në hierarkinë më komplekse të modelit të gjinisë, theksimi i rëndësisë së ndërveprimit të konteksteve lokale, rajonale dhe globale, një trajtim më specifik i mishërimit në kontekste privilegji dhe pushteti; dhe një fokusim më të madh në dinamikën e maskulinitetit hegjemonik, duke njohur kontradiktat e brendshme dhe arritjes së mundshme të demokracisë gjinore.

Fjalët kyçe: maskuliniteti; hegjemonia; gjinia; pushteti social; agjencia; mishërimi; globalizimi

Koncepti i maskulinitetit hegjemonik i krijuar dy dekada më herët ka ndikuar në masë të konsiderueshme në artikulet e fundit mbi burrat, gjininë dhe hierarkinë shoqërore. Ai ka ofruar një lidhje midis hulumtimeve në rritje në fushën e studimit mbi burrat (e njohur gjithashtu edhe si studimet mbi maskulinitetin apo studimet kritike mbi burrat), anktheve më të përhapura rreth burrave dhe djemve, artikulet feministe mbi patriarkatin dhe modelet sociologjike të gjinisë. Koncepti ka gjetur përdorim në shumë fusha të aplikueshme duke filluar nga edukimi, edukimi kundër dhunës, deri tek shëndeti dhe terapitë këshilluese.

Databazat e kërkimeve tregojnë se termi "maskulinitet hegjemonik" është përdorur në titujt apo abstraktet e më shumë se 200 shkrimeve. Shkrimet që përdorin këtë term apo i referohen "maskulinitetit hegjemonik" brenda në tekst janë me qindra. Interes i vazhueshëm është treguar edhe nga konferencat.. Në fillim të majit të vitit 2005, është mbajtur një konferencë "Maskuliniteti hegjemonik dhe politikën ndërkombëtare" në Universitetin e Mançesterit në Angli ndërsa në vitin

2004 në Shtutgart është mbajtur një konferencë ndërdisiplinare mbi temën "Hegemoniale Männlichkeiten" (Dinges, Ründal, and Bauer 2004).

Koncepti gjithashtu ka marrë kritika serioze nga disa disiplina si ajo sociologjike, psikologjike, post-strukturaliste dhe materialiste. (p.sh., Demetriou 2001; Wetherell and Edley 1999). Jashtë botës akademike, është sulmuar duke u cilësuar -për ta ,një replikë nga Interneti si "një shpikje nga psikologët e Kohës së Re" të vendosur për të dëshmuar se burrat janë shumë maço.

Ky është koncept i kontestuar. Megjithatë çështjet të cilat i identifikon janë qëndrore në përpjekjet bashkëkohore për pushtet, udhëheqje politike, dhunë publike dhe private dhe ndryshimet në familje dhe seksualitet. Një rishqyrtim ngjeshur i konceptit të maskulinitetit hegjemonik duket i nevojshëm. Nëse ky koncept dëshmohej ende të jetë i përdorshëm, ai duhe të riformulohet në terma bashkëkohorë. Këto janë dy përpjekjet kryesore që ky artikull synon t'i arrijë.

ORIGJINA, FORMULIMI DHE PËRDORIMI

Origjina

Koncepti i maskulinitetit hegjemonik është përdorur për herë të parë në raportet e dala nga hulumtimi në terren mbi pabarazitë shoqërore në shkollat e mesme në Australi (Kessler et al. 1982), dhe nga një diskutim konceptual mbi maskulinitetin dhe përvojat e trupave të burrave (Connell 1983) dhe në një debat tjetër mbi rolin e burrave në politikat e punës në Australi (Connell 1982). Projekti mbi shkollat e mesme ofroi dëshmi empirike të ekzistencës së hierarkive të shumfishta gjinore dhe klasore të ndërlidhura me përpjekjet aktive të bërjes së gjinisë (Connell po aty. 1982)

Këto pikënisje janë të strukturuar në artikullin "Drejt një Sociologjie të re mbi maskulinitetin" (Carrigan, Connell dhe Lee 1985) ku kritikohet gjerësisht literatura mbi "rolin seksual të mashkullit" dhe propozohet një model për shumësinë maskuliniteteve dhe marrëdhënieve të pushtetit. Kështu, ky model u integrua në një teori sociologjike sistematike mbi gjininë. Kjo rezultoi që shkrimi 6 faqësh *Gjinia dhe Pushteti* (Connell 1987) mbi "maskulinitetin hegjemonik dhe feminitetin e theksuar"¹ të bëhet burimi më i cituar mbi konceptin e maskulinitetin hegjemonik.

Koncepti i artikulluar nga grupet hulumtuese në Australi ka përfaqësuar një sintezë të ideve dhe dëshmive nga burime dukshëm të ndryshme. Por kryqëzimi i ideve nuk ishte aksidental. Çështje të ngjashme ishin duke u adresuar nga hulumtues/e dhe aktivistë/e në vende tjera, kështu që në një mënyrë, ishte koha për një sintezë të këtij lloji.

Burimet bazë ishin teoritë feministe mbi patriarkatin dhe debatet mbi rolin e burrave në transformimin e patriarkatit (Goode 1982; Snodgrass 1977). Disa burra në të Majtën e Re provuan të organizoheshin në mbështetje të feminizmit por ky tentim vetëm sa theksoi dallimet klasore në performimet e maskulinitetit midis tyre (Tolson 1977). Për më shumë, gratë e zeza si Maxine Baca Zinn (1982), Angela Davis (1983) dhe bell hooks (1984) kritikuan njënashmëritë racore që krijohen

¹ Shënim i përkthyesëve: Feminiteti i theksuar i referohet një modeli social të aprovuar të feminitetit i cili i pozicionon gratë si plotësuese dhe inferiore ndaj burrave.

atëherë kur pushteti trajtohet vetëm në terma të dallimeve seksuale, duke mundësuar kështu të vihet në pikëpyetje çdo pohim universalizues mbi kategorinë e burrave.

Termi gramshian i "hegjemonisë" përdoret aso kohe në tentativë për të kuptuar se si janë formuar marrëdhëniet klasore (Connell, 1977). Në kontekstin e teorisë së sistemeve të dyfishta (Eisenstein 1979), kjo ide lehtësisht u transferua edhe në problemin paralel të marrëdhënieve gjinore. Kjo rrezikonte keqkuptime të dukshme. Shkrimet e Gramshit fokusohen në dinamikën e ndryshimeve strukturore, përfshirë këtu mobilizimin dhe demobilizimin e klasave. Pa pasur një fokus të qartë në ndryshimet historike, idea e hegjemonisë do të reduktohej në një model të thjeshtë të kontrollit kulturor. Gjithashtu, në shumë prej debateve mbi gjininë, ndryshimi historik në shkallë të gjerë nuk është në fokus. Këtu është një nga burimet e problematikave të mëvonshme të konceptit maskuliniteti hegjemonik.

Edhe para lëvizjes për çlirim e grave, literatura në psikologjinë sociale dhe sociologji mbi "rolin seksual të mashkullit" e ka njohur natyrën sociale të maskulinitetit dhe mundësitë për ndryshimin e sjelljeve të burrave (Hackett 1957). Përgjatë viteve të 70-ta, kishte një fluks të hatashëm të shkrimeve mbi "rolin e burrit" duke kritikuar në mënyrë të mprehtë rolet normative si burim i sjelljeve shtypëse të burrave (Brannon 1976). Teoria kritike mbi rolet ofroi bazën kryesore konceptuale për lëvizjen e hershme të burrave kundër seksizmit. Megjithatë, mangësitë e teorisë së roleve të sekseve ishin duke u evidentuar çdo herë e më shumë (Kimmel 1987; Pleck 1981). Ato përfshinin turbullimin e sjelljes dhe normës, efektin hegjemonizues të konceptit të rolit dhe vështirësitë e tij në analizimin e pushtetit.

Pushteti dhe dallimi, në anën tjetër, ishin koncepte kyçe në lëvizjen geje për çlirim përmes së cilave u zhvillua një analizë e sofistikuar e shtypjes së burrave dhe shtypjes nga burrat (Altman 1972). Disa teori e shihnin çlirimin geje si kundërshtues të stereotipeve gjinore (Mieli 1980). Ideja e hierarkive të maskulinitetit doli drejtpërdrejt nga përvojat e burrave homoseksualë dhe dhunës e paragjykimeve që ata përjetuan nga burrat heteroseksualë. Koncepti mbi homofobinë u formësua në vitet e 70-ta dhe ky koncept veçse i atribuohet rolit mashkullor tradicional (Morin and Garfinkle 1978). Teoricienët/et zhvilluan artikuj të sofistikuar kundërshtues të marrëdhënies së komplikuar të burrave geje me patriarkatin dhe maskulinitetin tradicional (Broker 1976; Plummer 1981).

Një burim po aq i rëndësishëm ishin edhe hulumtimet shoqërore empirike. Hulumtimet në terren në rritje e sipër po dokumentonin hierarkitë lokale gjinore dhe kulturat lokale të maskulinitetit (Willis 1977), në hapësira pune të dominuara nga burrat (Cockburn 1983) dhe në komunitete të fshatrave (Herdt 1981; Hunt 1980). Këto studime ofruan realizmin etnografik që i mungonte literaturës mbi rolet gjinore, konfirmuan se ekziston një shumësi e maskuliniteteve dhe kompleksitetin e sajimit të gjinisë për burrat si dhe ofroi dëshmi për përpjekjet aktive për dominim që është tërthorazi i përfshirë në konceptin gramshian të hegjemonisë.

Për fund, ky koncept u frymëzua edhe nga psikoanaliza. Vetë Freud prodhoi analizën e parë biografike të burrave dhe në rastin e *Burrit Ujk*, tregoi se personaliteti i një të rrituri funksionon përmes një sistemi i cili është tërë kohës nën tension, ku mendimet kundërshtuese shtypen por nuk zhduken (Freud [1917] 1955). Psikoanalisti Stoller (1968) popullarizoi konceptin e "identitetit gjinor" dhe identifikoi llojlojshmëritë e tij në zhvillimin gjinor të djemve, sidomos tek transeksualizmi. Të tjerët që ishin të ndikuar nga psikoanaliza filluan të përdorin temat si pushteti i

burrave, mundësitë në zhvillimin gjinor, tensioni dhe kundërshtitë përbrenda maskulinitetit tradicional (Freidman dhe Lerner 1986; Zaretsky 1975)

Formulimi

Çka rezultoi në mesin e viteve 80 - ta nga ky matriks është një analog, në terma gjinor, mbi hulumtimet e strukturave të pushtetit në sociologjinë politike, duke vendosur në qendër në grupet dominante. Maskuliniteti hegjemonik u kuptua si një rrjetë e praktikës (p.sh gjërat që i bën, jo vetëm një set rolesh të pritshme ose një identitet të caktuar të cilin e performon) që lejon shtypjen e burrave ndaj grave të vazhdojë.

Maskuliniteti hegjemonik u dallua nga maskulinitetet tjera, specifikisht nga ato të nënshtruara . Maskuliniteti hegjemonik nuk u mendua të jetë normal në terma statistikor; vetëm një grup i vogël i burrave mund ta performojnë atë. Por gjithsesi se ai ishte normativ. Ky variant mishëron mënyrën më të ndershme të të qenunit burrë, duke mundësuar që të gjithë burrat të pozicionohen në raport me të dhe duke legjitimuar ideologjikisht nënshtrimin global të grave ndaj burrave.

Burrat që përfitonin nga patriarkati pa performuar një version të fortë të dominimit maskulin mund të përceptoheshin edhe si performues të një maskuliniteti që është bashkëfajtor. Raportime këtë grup specifik dhe me pajtushmërinë që ekzistonte mes burrave heteroseksualë, ishte ai që e bënte konceptin e hegjemonisë edhe më të fuqishëm. Hegjemonia nuk nënkupton dhunë, edhe pse mund të mirëmbahet nga forca; ajo nënkupton një superioritet i cili mirëmbahet përmes kulturës, institucioneve dhe bindjes.

Këto koncepte ishin më shumë abstrakte sesa përshkruese, të definuara përmes termave dhe logjikës patriarkale të sistemit gjinor. Ato presupozonin se marrëdhëniet gjinore janë historike dhe se hierarkitë gjinore mund të ndryshojnë. Kështu maskulinitetet hegjemonike erdhen në pah nën rrethana specifike dhe ishin të hapura ndaj ndryshimeve historike. Specifikisht, mund të ekzistonten një përpjekje për hegjemoni dhe format me të vjetra të maskulinitetit mund të zëvendësoheshin me disa të reja. Këtu Ndoshta ishte e mundshme që një menyrë më humane, më pak shtypëse e të qenunit burrë, mund të bëhej hegjemonike, si pjesë e një procesi që do të çonte drejt zhbërjes së hierarkive gjinore.

Aplikimi

Koncepti i maskulinitetit hegjemonik i artikulluar në këto terma gjeti përdorim të gjerë. Në fund të viteve 80-ta dhe 90- ta, hulumtimet mbi burrat dhe maskulinitetin filuan të njihen si fushë akademike duke u mbështetur nga shumë konferenca të organizuara, publikime të teksteve të ndryshme dhe revistave, si dhe një zgjerim të shpejtë të agjendës së hulumtimeve në shkencat sociale dhe humanistike.

Koncepti i maskulinitetit hegjemonik përdorej në fushën e edukimit për të kuptuar dinamikën e klasave në shkollë, përfshirë këtu rrjetat e praktikave të rezistencës dhe përqeshjes mes djemve. Ai përdorej për të analizuar marrëdhëniet me kurikulën dhe vështësitë që dilnin nga pedagogjia që ishte neutrale ndaj gjinisë (Martino 1995). Gjithashtu, përdorej për të kuptuar strategjinë e mësuesve dhe identitetet e tyre në grupe siç ishin profesorët e edukimit fizik (Skelton 1993).

Koncepti pati ndikim edhe në fushën e kriminalistikës. Të gjitha të dhënat tregojnë se burrat dhe djemtë kryejnë shumicën e krimeve të zakonshme, dhe krimeve më të rënda për dallim me gratë dhe vajzat. Për më shumë, burrat mbajnë një monopol virtual në kryerjen e krimeve në sindikata dhe krimet nga jakëbardhët.² Koncepti i maskulinitetit hegjemonik ndihmoi në teroizimin e marrëdhënies mes maskuliniteteve në disa prej krimeve (Messerschmidt 1993) dhe përdorej në studime mbi disa krime specifike të burrave dhe djemve sikurse përdhunimet në Zvicër, vrasjet në Australi, huliganizmi në futboll, krimi i jakëbardhëve në Angli dhe dhunës fizike në Shtetet e Bashkuara (Newburn dhe Stanko 1994).

Koncepti filloi të përdorej edhe në studimet mbi përfaqësimin mediatik të burrave, për shembull, ndërveprimi i sportit me imazhin e luftës (Jansen dhe Sabo 1994). Për shkak se koncepti i hegjemonisë ndihmoi në kuptim-dhënien e diversitetit dhe mënyrës se si përzgjedhen imazhet në media, hulumtimet mediatike filluan të hartëzojnë lidhjet midis përfaqësimit të maskuliniteteve të ndryshme (Hanke 1992). Sportet komerciale janë një fokus i përfaqësimit mediatik të maskulinitetit, gjithashtu edhe fusha e sociologjisë së sportit e cila është në zhvillim gjeti përdorim të theksuar të konceptit të maskulinitetit hegjemonik (Messner 1992). Koncepti gjeti përdorim edhe në analizën e popullaritetit që gëzojnë sportet ku trupat kanë kontakt fizik dhe konfrontohen -funksiononin e tij si simbol vazhdimisht i ripërtrishëm i maskulinitetit- dhe për të kuptuar dhunën dhe homofobinë që rëndom zhvillohet në këto mjedise sportive (Messner dhe Sabo 1990).

Përcaktuesit shoqëror të shëndetit të burrave është trajtuar edhe më herët, mirëpo koncepti i rolit të seksit ishte shumë i shpërndarë për të qenë i përdorshëm. Konceptet e maskuliniteteve të shumëta dhe maskulinitetit hegjemonik u përdorën për të kuptuar më mirë praktikat shëndetësore të burrave si për shembull kur shtiren sikur janë lënduar apo sjellje tjera seksuale që përbëjnë rrezik të lartë (Sabo dhe Gordon 1995). Konceptet e maskuliniteteve hegjemonike dhe të nënshtruara ndihmuan të kuptohet më mirë jo vetëm ekspozimi i burrave ndaj rrezikut por edhe vështirësitë e burrave për ta trajtuar aftësinë e kufizuar dhe lëndimin. (Gerschick dhe Miller 1994).

Koncepti i maskulinitetit hegjemonik u dëshmuar i rëndësishëm edhe në studimet mbi organizimin, pasi që karakteri gjinor i burokracive dhe në vendeve të punës vetëm sa vihej në pah. Studimet etnografike dhe intervistuese gjurmuan institucionalizimin e maskulinitetit hegjemonik në disa organizata specifike (Cheng 1996; Cockburn 1991) dhe rolin e tyre në vendimmarrje (Messerschmidt 1995). Në fokus të veçantë ishte ushtria, ku praktika specifike të maskulinitetit hegjemonik ndonëse ishin farkëtuar, kishin filluan të bëhen tejet problematike (Barrett 1996).

Edhe diskutimet mbi praktikat profesionale e panë konceptin si të dobishëm. Këto praktika përfshijnë psikoterapinë me burra (Kupers 1993) programet për parandalim të dhunës me të rinjë (Denborough 1996), dhe programet për edukim emocional të djemve (Salisbury dhe Jackson 1996).

Këto janë fushat kryesore ku koncepti i maskulinitetit hegjemonik është përdorur në dekadën kur edhe është konceptuar. Mirëpo koncepti gjeti aplikim edhe më të gjerë, si për shembull në diskutimet mbi artin (Belton 1995), në disiplina akademike si gjeografia (Berg 1994), ligji (Thornton 1989) dhe në diskutime të përgjithshme mbi politikat gjinore të burrave dhe në lidhje me

² Shënim i përkthyesëve: Krime jo të dhunshme të kryera nga punëtorët me jakë të bardhë që punojnë në zyrë, veçanërisht krime si korrupsioni.

feminizmin (Segal 1990). Në lehtësisht mund të themi se analiza e maskuliniteteve të shumfishta dhe koncepti i maskulinitetit hegjemonik shërbeu si bazë për hulumtimet mbi burrat dhe maskulinitetin, duke e shkëmbyer atë me teorinë e rolit seksual dhe modelet kategorike të patriarkatit.

Përfundimisht, hulumtimet ndihmuan në zgjerim të vetë konceptit. Ky zgjerim u mishërua në katër forma të ndryshme: duke dokumentuar kostot dhe pasojat e hegjemonisë, duke zbuluar mekanizmat e hegjemonisë, duke treguar diversitetet në maskulinitetet dhe duke gjurmuar ndryshmet në maskulinitetet hegjemonike.

Sa i përket kostove dhe pasojave, hulumtimët në kriminalistikë kanë treguar se si disa praktika specifike të dhunës ishin të lidhura me maskulinitetin hegjemonik, jo si efekt mekanik ku hegjemonia ishte shkaku mirëpo përmes prirjes drejt hegjemonisë (Bufkin 1999; Messerschmidt 1997). Për më shumë, hulumtimi udhërrëfyes i Messner (1992) tregoi se performimi i maskulinitetit hegjemonik në sportet profesionale, teksa riprodhon hierarki të rrëpira, vjen gjithashtu edhe me çmim për fitimtarët në terma të dëmit emocional dhe fizik.

Hulumtimet kanë qenë të frytshme në shpërfaqjen e mekanizmave të hegjemonisë. Disa janë tejet të dukshme, si spektaklet e maskulinitetit në televizionet sportive (Sabo dhe Jansen 1992) gjithashtu edhe mekanizmat social të cilët Roberts (1993) i quan "cenzurë" të drejtuar drejt grupeve të nënshtruara - që shpërfaqen në praktikat si etiketimet ofenduese nga fëmijët deri te kriminalizimi i sjelljeve homoseksuale. Megjithatë mekanizmat tjerë të hegjemonisë veprojnë si të padukshëm, si largimi i një forme të maskulinitetit dominant nga mundësia për cenzurë (Broën 1999). Consalvo (2003) në analizën e raportimeve meditare mbi masakrën në shkollën e mesme *Columbine* vëren se si idea e maskulinitetit nuk u morrë parasysh, dukë mos iu lënë rrugë tjetër mediave veç se t'i portretizojnë vrasësit si 'përbindësia'.

Hulumtimet ndërkombëtare kanë konfirmuar fuqishëm atë që veçse ishte artikualuar, se rendiet gjinore krijojnë maskulinitete të shumëta. Valdes and Olavarria (1998) tregojnë se edhe në vende kulturalisht homogjene sikurse është Kili, nuk ka vetëm një maskulinitetit, pasi që shumëfisja e tij kushtëzohet nga klasa dhe gjenerata. Në një vend tjetër të njohur si homogjen si Japonia, Ishii - Kuntz (2003) gjurmon 'shpërfaqjen e maskuliniteteve diverse' në historinë e re shoqërore në ndryshimet në praktikën e përkujdesjes së fëmijëve. Diversiteti maskulinitetve është gjetur gjithashtu edhe në disa institucione specifike, siç është ushtria (Higate 2003).

Gutmann (1996), në etnografinë moderne më bukur të vrojtuar mbi maskulinitetin ka studiuar një rast ku maskuliniteti është një identitet publik i mirë definuar, - "maçoizmi" meksikan. Gutman tregon se si imazhi i maçoizmit është zhvilluar historikisht dhe është ndërlidhur me zhvillimin e nacionalizmit meksikan, duke maskuar kështu kompleksitetin e jashtëzakonshëm në jetët reale të burrave meksikanë. Gutmann trajton katër praktika të maskulinitetit në vendbanimet urbane të klasës punëtore, duke insistuar se edhe këto katër praktika janë tërthorazi të ndikuara nga ndarjet tjera shoqërore dhe vazhdimisht të rinegociuara në përditshmëri.

Përfundimisht, një numër i madh i hulumtimeve tregojnë se jo vetëm që ka maskulinitete të ndryshme por edhe që ato janë subjekte të ndryshimit. Kundërshtimet e hegjemonisë janë të zakonshme e poashtu edhe përshtatjet në ballë të këtyre kundërshtimeve. Morrell (1998) mbledhë dëshmitë lidhur me transformimet gjinore në Afrikën e Jugut të cilat erdhën si pasojë e përfundimit të aparteidit-it, një sistem i patriarkateve të segreguara dhe konkurruese. Ferguson

(2001) gjurmon shembjen e idesë të kahmotshme të maskulinitetit në Irlandë - priftit të pamartuar dhe burrit familjar punëtorë - të cilët janë zëvendësuar me disa modele tjera më moderne dhe të orientuara nga tregu. Dasgupta (2000) gjurmon tensionet në Japoni midis modelit të maskulinitetit të burrit me rrogë, specifikuat pas ekonomisë fluskë³ të viteve 1980. Figura kulturore "ikjes së burrit me rrogë" r u shfaq. Taga (2003) dokumenton përgjigjet e ndryshme ndaj këtyre ndryshimeve në mesin e burrave të rinj të klasës së mesme në Japoni, përfshirë këtu opsione të reja të bashkëjetesës me gra. Meuser (2003) gjurmon ndryshimet mes gjeneratash në Gjermani, të cilat erdhën kryesisht si pasojë e përgjigjes së burrave kundrejt ndryshimeve në mesin e grave. Shumë (ndonëse jo të gjithë) burra të rinj, duke pritur nga gratë t'i refuzojnë raportet patriarkale shoqërore, janë duke formësuar një një "egalitarizëm pragmatik" të tyre. Morris dhe Evans (2001) teksta studiojnë imazhet e maskulinitetit dhe feminitetit rural në Angli, evidentojnë një ngadalësim në ndryshime por një mendjeprehtësi dhe fragmentim në përfaqësimin e maskulinitetit hegjeonik.

Që nga mesi i viteve 1980 deri në vitet fillim të të 2000-ave, koncepti i maskulinitetit hegjeonik kaloi nga një model konceptual me një bazë të ngushtë empirike, në një kornizë gjerësisht të përdorur në hulumtime dhe diskutimet mbi burrat dhe maskulinitetet. Koncepti u aplikua në kontekste të ndryshme kulturore dhe në shumë çështje praktike. Nuk është e çuditshme pra, që ky koncept mori shumë kritika, ku edhe do të kthehem tani.

KRITIKAT

Pesë kritika kryesore janë zhvilluar që nga fillimi i diskutimeve mbi konceptin në fillim të viteve 1990. Në këtë pjesë, ne vlerësojmë secilën kritikë me shpresën që të kuptojmë se çfarë është e rëndësishme të ruhet nga konceptimi origjinal i maskulinitetit hegjeonik dhe çfarë duhet riformular.

Koncepti themelor i maskulinitetit

Që koncepti bazë i maskulinitetit ka mangësi është diskutuar nga dy këndvështrime të ndryshme, ai realist dhe post-strukturalist. Për Collinson dhe Hearn (1994) dhe Hearn (1996, 2004), koncepti i maskulinitetit është i mjegullt, i paqartë në kuptimin e tij dhe tenton të largojë vëmendjen nga çështja e pushtetit dhe dominimit. Përfundimisht, është i panevojshëm në përpjekjen për të kuptuar dhe luftuar pushtetin e burrave. Koncepti i maskuliniteteve të shumëta tenton të prodhojë një tipologji statike.

Për Petersen (1998, 2003), Collier (1998), dhe MacInnes (1998), koncepti i maskulinitetit është i mangët sepse esencializon karakterin e burrave dhe imponon një unitet të rrejshëm përbrenda një realiteti të lëngshëm dhe kontradiktor. Disa versione të këtij argumenti kritikojnë hulumtimin mbi maskulinitetin në atë që ai nuk përdorin një metodë specifike poststrukturaliste që do të theksonte për shembull sajimin diskursiv të identiteteve (Whitehead 2022). Koncepti i maskulinitetit është kritikuar si një koncept i ndërthuar përmes koncepteve heteronormative të gjinisë të cilat esencializojnë dallimet femër - mashkull dhe injorojnë dallimet dhe përjashtimet përbrenda gjinisë. Koncepti i maskulinitetit funksionon me logjikën e dikotomisë mes seksit (biologjik) dhe gjinisë (kulturore) dhe në këtë mënyrë marginalizon dhe natyralizon trupin.

³ Shënim i përkthyesëve: Ekonomia fluskë i referohet ekonomisë së paqëndrueshme në zgjerim e sipër; në veçanti, një periudhë e rritjes së prosperitetit dhe rritjes së aktivitetit tregtar në Japoni në fund të viteve 1980, e shkaktuar nga normat e interesit të rregulluara artificialisht.

Asnjë mendje e arsyeshme nuk mund ta mohojë se në të gjithë literaturën ekzistuese mbi maskulinitetin, ka konfuzion konceptual dhe esencializim në masë të madhe. Kjo gjithsesi se është shumë e shprehur në trajtimin e maskulinitetit nga psikologjia e popullarizuar, në lëvizjen e burrat mito-poetikë⁴, dhe në interpretimet e revistave të hulumtimeve biologjike të dallimeve seksuale. Megjithatë, është çështje tjetër të thuash se koncepti i maskulinitetit është konfuz apo esencialist ose se përdorimi i konceptit nga hulumtuesi/ja e është asisoji.

Ne do të argumentonim se hulumtimet e shkencave shoqërore dhe humanistike mbi maskulinitetin kanë marrë hov këto 20 viteve të fundit pikërisht për faktin se koncepti bazë nuk është as konkret apo esencialist. Nocioni që koncepti i maskulinitetit esencializon apo homogjenizon është vështirë i pajtueshëm me shumësinë e jashtëzakonshme të sajësve shoqërore që enografët/et dhe historianët/et kanë dokumentuar pikërisht përmes përdorimit të këtij koncepti (Connell 2003). Diçka që shkon edhe më larg nga esencializmi është fakti që hulumtuesit/et kanë eksploruar maskulinitete të performuara nga trupa femëror (Halberstam 1998; Messerschmidt 2004). Maskuliniteti nuk është një entitet i fiksuar i mishëruar në trupa ose tipare të personalitetit të individëve. Maskulinitetet janë disa trajta të praktikave të cilat aktualizohen në veprim shoqëror dhe rrjedhimisht mund të ndryshojnë varësisht marrëdhënieve gjinore në kontekste të caktuar shoqërore.

Ideja se njohja e shumësisë së maskuliniteteve çonë në një tipologji statike me siguri nuk ka derivuar nga zhvillimi i hulumtimit. Një shembull i kësaj paradigme është etnografia në Meksikë e Gutmann (1996), e cila veçse është përmendur. Gutmann është në gjendje të sjellë disa kategori të maskulinitetit si për shembull -atë maço dhe atë *mandilion*⁵ - duke e njohur dhe duke vënë në pah në detaje faktin se këto nuk janë identitete në vakum por janë gjithmonë në raport dhe të kryqëzuara prej ndarje dhe projekteve tjera. Vëzhgimet e Warren (1997) në një shkollë fillore britanike ofrojnë një shembull tjetër. Sajesa të ndryshme të maskulinitetit janë gjetur, çka krijojnë efektë në rutinën e klasës edhe pse shumë djem nuk përshtaten tërësisht brenda kategorive të mëdha; me të vërtetë djemtë demonstrojnë raporte komplekse të përqafimit apo refuzimit të këtyre kategorive.

Ndonëse ideja se koncepti mbi gjininë është mishërim i heteronormativitetit është tashmë një kritikë e njohur (Hawkesworth 1997), ajo është një kritikë e kontestuar (Scott 1997). Ndonëse drejt identifikon problem në modelet kategorike të gjinisë, nuk paraqet kritikë e vlefshme për modelet e raporteve të gjinisë [me kategori dhe kontekste tjera] (psh. Connell 2002; Walby 1997) apo qasjeve historike ku sajimi i kategorive gjinore është objekt studimi. Përgjatë zhvillimit të konceptit të maskulinitetit hegjemonik, ndarjet mes burrave, veçanërisht përjashtimi dhe shtypja e burrave homoseksualë, kanë qenë çështje thelbësore (Carrigan, Connell dhe Lee 1985). Që nga atëherë, policimi i heteroseksualitetit ka qenë tema kryesore në diskutimet mbi maskulinitetin hegjemonik.

Ideja që koncepti i maskulinitetit e margjinalizon dhe natyralizon trupin (duke qenë se supozohet që ndërtohet në dikotominë gjini - seks) është ndoshta nga pohimet më të çuditshme në këtë

⁴ Shënim i përkthyesëve: Lëvizja mito-poetike e burrave ishte një lëvizje ku burrat organizoheshin në aktivitetet dhe punëtori terapeutike në Shtetet e Bashkuara nga fillimi i viteve 1980 deri në vitet 1990.

⁵ Shënim i përkthyesëve: Term i përdorur në kulturën meksikane për burra që nuk kanë pushtet në marrëdhënien martesore dhe i binden gruas.

kritikë. E çuditshme sepse ndërveprimi midis trupave dhe proceseve shoqërore ka qenë një ndër temat kryesore të kërkimeve mbi maskulinitetin të nga fillet e tyre. Një ndër hulumtimet e para dhe më qenësore në këtë pardigmë të re ka qenë hulumtimi i Messner (1992) rreth maskulinitetit të atletëve profesionalë, ku është ekzaminuar përdorimi i "trupit si armë" dhe dëmet afatgjata në trupat e burrave. Ndërtimi i maskulinitetit në kontekst të aftësive të kufizuara (Gerschik dhe Miller 1994), trupave punëtorë të burrave të klasës punëtore (Donaldson 1991), shëndeti dhe sëmundjet e burrave (Sabo dhe Gordon 1995) dhe dhuna ndërpersonale mes djemve (Messerschmidt 2000) kanë qenë disa nga temat e hulumtimit të cilat tregojnë se si ndikohet trupi nga proceset shoqërore. Diskutimet teorike kanë eksploruar rëndësinë e një Sociologjie të re mbi trupin për krijimin e maskulinitetit. (psh Connell 1995, kapitulli 2)

Kritikat kundrejt konceptit të maskulinitetit kanë më shumë kuptim kur drejtojnë gishtin drejt një tendence në fushën e hulumtimit dhe literaturës së popullarizuar për të dikotomizuar përvojat e burrave dhe grave. Siç vëzhgon saktë Brodi (1994) ekziston një tendencë në fushën e studimeve mbi burrat që aludon në 'sfera të ndara', e cila pretendon se gratë nuk janë pjesë rëndësishme e analizës, dhe që maskuliniteti të analizohet duke shikuar vetëm burrat dhe marrëdhëniet midis burrave. Siç argumenton edhe Brod, kjo nuk është e pashmangshme. Zgjidhja qëndron në trajtimin e gjinisë në terma të marrëdhënieve - jo duke braktisur konceptet e gjinisë dhe maskulinitetit.

Paqartësia dhe mbivendosja

Kritikat e hershme mbi konceptin ngritën çështjen se kush në fakt e përfaqëson maskulinitetin hegjemonik. Veç se është e dëshmuar se burrat që kanë pushtet shoqëror nuk mishërojnë një maskulinitet ideal. Në anën tjetër, Donaldson (1993) vërenë nuk duket se ka shumë substancë maskuline në ata burra që identifikohen nga hulumtuesit/et si modele hegjemonike. Ai diskuton rastin kampionit australian të sportit të surf-it të quajtur si "burri hekurtë" të përmendur të Connell (1990), si një shembull të popullarizuar të maskulinitetit hegjemonik. Por statusi hegjemonik i burrit të ri në nivel rajonal e privon atë të bëjë gjëra që grupi i bashkëmoshatarëve të tij lokalë e definojnë si maskuline -të bëjë gjëra të çmendura, të bëhet pompoz, të vozisë i dehur, të përfshihet në përleshje fizike dhe të mbrojë prestigjin e tij.

Martin (1998) kritikon se konceptin çonë drejt aplikimeve jokonsistente t, duke iu referuar në disa raste lloji fiks të maskulinitetit dhe në raste tjera duke iu referuar çfarëdo lloji që është më dominant në një kohë dhe vend specifik. Ngjajshëm, Wetherell dhe Edley (1999) thonë se koncepti dështon të specifikojë se si përshtatja ndaj maskulinitetit hegjemonik merrë formë në praktikë. Gjithashtu edhe Whitehead (1998, 58; 2002; 93) sugjeron se ka hutim rreth asaj se cili është burri hegjemonikisht maskulin, a është John ëayne, Leonardo Dicaprio, Mike Tyson apo Pele? Ose në kohë të ndryshme, të gjithë këta? - dhe se kush mund të performojë praktika hegjemonike.

Ne mendojmë se keto kritika në mënyrë legjitime trajtojnë paqartësitë në përdorim. Është e dëshirueshme që të eliminohet çdo përdorim i maskulinitetit hegjemonik si model i fiksuar dhe transhistorik. Përdorimi i tillë cënon historicitetin e gjinisë dhe injoron dëshmitë e shumëta në ndryshimet e definimeve shoqërore të maskulinitetit.

Veç se në aspekte tjera, mund të jetë e rëndësishme që paqartësia në proceset gjinore të shihetsi mekanizëm i hegjemonisë. Mendohen se si një definicion i idealizuar i maskulinitetit është formuar nëpër procese shoqërore.. Në nivel të shoqërisë së gjerë (të cilit do ti referohemi në këtë shkrim si nivel rajonal) ekziston një qarkullim i modeleve të sjelljes maskuline që admirohen, që mund mirëmbahet nga kishat, rrëfyer nga mediat masive ose promovohet nga shteti. Këto modele i referohen por edhe në një formë e shtrembërojnë përditshmërinë e praktikave shoqërore. Një shembull klasik do të ishte lavdërimi i punëtorit industrial *Stakhanovite* në regjimin sovietik, i emëruar sipas minatorit Aleksandr Stakhanov i cili në vitin 1935 theu rekordin botëror duke nxjerrë 102 tonë thëngjill brenda një dite, duke aktivizuar kështu të tjerët në përpjekje për ta thyer këtë rekord. Pjesë e shtrembërimit këtu ishte se “punëtorët e famshëm shokues” i arritën këta numra përmes ndihmës së panjohur të kolegëve të tyre.

Kështu, maskulinitetet hegjemonike mund edhe të ndërtohen në atë mënyrë që nuk përkojnë me jetët e asnjë nga burrat aktualë. Megjithatë këto modele në forma të ndryshme shpërfaqin ideale, fantazi dhe dëshira të shpërndara gjerësisht. Ato ofrojnë modele të marrëdhënieve me gra dhe zgjidhje të problemeve të marrëdhënieve gjinore. Për më shumë, ato artikulojnë pjesërisht me krijimin praktik të maskuliniteteve si mënyre e jetesës se burrave nën rrethanat e përditshmërisë lokale. Duke bërë këtë, ato kontribuojnë në hegjemoninë e rendit gjinor në të gjithë shoqërinë si tërësi. Pra nuk e befasishtme që burrat që funksionojnë si shembuj në nivelin rajonal, sikurse ishte rasti i burrit të hekurtë të Donaldson (1993) shpërfaqin kontradikta.

Në nivelin lokal, praktikat hegjemonike të maskulinitetit janë të mishëruar në ambiente shoqërore specifike, siç janë organizimet formale. Ekzistojnë praktika të maskulinitetit menaxherial në korporata britanike të cilat janë studiuar nga Roper (1994) dhe Wajcman (1999). Modelet e maskulinitetit hegjemonik të cilat janë të legjitimuara nga shoqëria janë prezente edhe në familje. Për shembull, strategjitë gjinore të burrave formësojnë negociimet rreth punës së shtëpisë dhe “ndërrimit të dytë” në familjet në Shtetet e Bashkuara, siç e ka studiuar Hoschchild (1989). (Modelet hegjemonike të maskulinitetit vijnë në pah dhe kontestohen teksa fëmijët rriten. Gjinia bëhet në shkollë dhe lagje përmes strukturave të grupeve të bashkëmoshatarëve, kontrollit mbi hapësirëat e shkollës, modeleve të lidhjeve romantike, ligjëritimit homofobik dhe ngacmimit (Mac dhe Ghail 1994; Thorne 1993). Në asnjërën prej këtyre rasteve nuk mund të presim që maskuliniteti hegjemonik të veçohet si praktikë e ndarë nga praktikat tjera. Gjasat që të ndodhë mbivendosja ose zbehja e kufive të maskuliniteteve hegjemonike dhe atyre bashkëfajtoresh janë shumë të mëdha, në rastet kur hegjemonia është efektive.

Mbivendosja midis maskuliniteteve mund të vërehet edhe në termat e bërjes së maskuliniteteve përmes agjentëve shoqëror. Cavender (1999) tregon se si modelet maskuline hegjemonike kanë qenë ndryshe të sajuara në filmat artistikë të viteve të 1940-a krahasuar me ato të viteve 1980-a. Kjo nuk është vetëm çështje e karaktereve të shkruara në skripta. Praktika në nivel lokal- e që është ndërveprimi sy me sy në xhirimin e filmit si aktorë - në instancë të fundit ndërton fantazitë e modeleve të maskulinitetit hegjemonik (në këtë rast detektivët) në nivel të shoqërisë së gjerë apo në nivel rajonal (Do ta eksplorojmë tutje këtë çështje të ndërveprimit në mes të niveleve në kapitullin e Reformulimit)

Problemi i konkretizimit

Që koncepti i maskulinitetit hegjemonik redukton, në praktikë, një konkretizim të pushtetit apo toksicitetit është diçka që është argumentuar nga pikëpamje të ndryshme. Holter (1997, 2003) në kritikën më të sofistikuar konceptuale, argumenton se ky koncept artikulon pushtetin e burrave

përmes përvojave të grave dhe jo nga baza strukturore e nënshtrimit të grave. Holter beson se ne duhet të bëjmë dallimin midis 'patriarkatit', strukturës jetë-gjatë të shtypjes së grave dhe 'gjinisë' një sistem specifik i shkëmbimit i cili morri hov përgjatë zhvillimit të kapitalizmit modern. Është gabim të trajtosh hierarkinë e maskuliniteteve të ndërtuar përbrenda marrëdhënieve gjinore përmes të njëjtës linjë logjike sikur se trajtohet shtypja patriarkale e grave. Holter (1997) ofron dëshmi nga një hulumtim norvegjez i cili tregon se identitetet gjinore të burrave nuk shpërfaqen në mënyrë të drejtpërdrejtë në praktikën që kanë të bëjnë me barazinë sikurse është qasja ndaj dhunës.

Holter (1997, 2003) është e saktë kur thotë se është gabim të deduktohen raportet mes maskuliniteteve nga ushtrimi i drejtpërdrejt i pushtetit personal të burrave kundrejt grave. Në më të paktën, ne duhet të marrim parasysh edhe institucionalizimin e pabarazisë gjinore, rolin e sajësive kulturore dhe bashkëveprimin e dinamikave gjinore me racën, klasën dhe identitetin rajonal.

Me të vërtetë, hulumtimet mbi këto çështje tregojnë se koncepti i maskulinitetit nuk është kurthuar nëkonkretizim. Në mesin e hulumtimeve të frytshme të maskuliniteteve të institucionalizuara janë ato që sipërfaqësojnë variacione të fshehura, si përshembull në mes të formacioneve të ndryshme të një force ushtarake të vetmesi ajo e Marinës së ShBA-ve (Barrett 1996). Ka studime mbi maskulinitetet hegjemonike specifike lokale të krijuara në hapësira si ajo e pijetores vendase të Zelandës së Re që shpërfaqë gërshetimin e maskulinitetit me identitetin rural (Campbell 2000). Hulumtimet tjera, sidomos ato që studiojnë klasët brenda shkollave (Martino 1995; Warren 1997) e tregojnë prodhimin e hollë dhe negocimin e maskuliniteteve (dhe feminiteteve) si konfigurim i praktikave.

Collier (1998) e kritikon konceptin e maskulinitetit hegjemonik në termat e përdorimit të tij tipik kur trajton dhunën dhe krimin. Në 'kthesën maskuline' në kriminalistikë, Collier sugjeron se maskuliniteti hegjemonik asociohet vetëm me nota negative që përshkruan burrat si individë pa emocione, të pavarur, të pa - kujdesshëm, agresivë dhe jopasionantë, tipare këto të cilat mundësojnë sjellje kriminale. Ngjashëm, Martin (1998, 473) thekson një kthesë në trajtim të maskulinitetit hegjemonik jo thjesht si model por si model negativ, sidomos në ato raste kur thuhet se 'mbrojtja e posedimit të armëve është mbrojtje e maskulinitetit hegjemonik'.

Kjo kritikë ka bazë. Ajo ndërtohet mbi analizën e thuktë të McMahon-it (1993) në psikologjizimin e shumë diskutimeve mbi burrat dhe maskulinitetet. Sjellja e burrave shpjegohet përmes një koncepti të maskulinitetit i cili, përmes argumentit qarkor, shëndrrohet në arsyetim dhe shpjegim për sjelljen e tyre. Kjo mund të vërehet në shumë diskutime mbi shëndetin e burrave dhe problemet përgjatë edukimit të djemve - me të vërtetë të gjitha problematikat bashkëkohore sillen rreth banderolës së një "krize të maskulinitetit". Në psikologjinë e popullarizuar, shpikja e llojeve të reja të karaktereve është endemike (mashkulli alfa, djali i ndjeshëm i kohës së re, burri me shumë lesh, dhe "miush"⁶ etj). Në këtë hapësirë, maskuliniteti hegjemonik mund të bëhet një sinonim shkencor për tipin maço i cili nënkupton një burrë të ngurtë, shtypës dhe seksist. (në përdorim anglez, shih Mosher dhe Tomkins 1988).

⁶ Shënim i përkthyesëve: Term pezhorativ që i referohet djemve që luajnë shumë lojëra virtuale, janë të papërvojë apo jashtë standardeve të pranueshme të bukurisë

Duke qenë se koncepti i maskulinitetit hegjemonik bazohet në praktikat që mundësojnë që dominimi kolektiv i burrave mbi gratë të vazhdojë, nuk është e çuditshme që në disa kontekste, maskuliniteti hegjemonik në fakt i referohet praktikave toksike të burrave, duke përfshirë këtu dhunën fizike e cila stabilizon shtypjen gjinore në një hapësirë të caktuar. Megjithatë, dhuna dhe praktikat tjera të dëmshme nuk janë gjithmonë karakteristikat përkufizuese të saj, duke qenë se hegjemonia ka trajta të shumfishta. Sikurse ëtherrell dhe Edley (1999) në mënyrë ironike vëzhgojnë, një nga mënyrat më efektive të të qenunit "burrë" në kontekste lokale mund të jetë demonstrimi i distancimit nga maskuliniteti hegjemonik rajonal.

Collier (1998) sheh të metë kyçe në konceptin e maskulinitetit hegjemonik e që është përjashtimi i sjelljeve "pozitive" tek burrat si për shembull ato sjellje që i shërbejnë interesave dhe dëshirave të grave. Kjo vështirë që paraqet problem, nëse veç e tejkalojmë teorinë e tipareve të ngurta të personalitetit. Shumë prej shtjellimeve mbi maskulinitetit hegjemonik në fakt përfshijnë veprimet "pozitive" si ajo e sjelljes së pagës në shtëpi, mirëmbajtjen e një marrëdhënieje seksuale dhe atë të të qenunit baba. Me të vërtetë, do të ishte e vështirë të shihej se si koncepti i hegjemonisë do të ishte i përdorshëm nëse të vetmet karakteristika të grupit dominues do të ishin dhuna, agresioni dhe egocentrizmi. Këto karakteristika do të mund të nënkuptonin dominim por vështirë se do të krijonin hegjemoni -një ide që kërkon nocione të caktuara të pëlqimit dhe përfshirjes së grupeve nënshtruara.

Collier (1998, 21) ka të drejtë kur vërenë se ajo çfarë po diskutohet në shtjellimet mbi maskulinitetit hegjemonik dhe krimin (këtu mund të përfshijmë edhe shëndetin dhe edukimin) është një "mori e idelogjive të popullarizuara që konstituojnë karakteristikat ideale apo reale të të qenunit "burrë". Megjithatë, çka Collier nuk përfshinë këtu është fakti se hulumtimet e sofistikuara vazhdimisht eksplorojnë marrëdhënien e këtyre ideologjive në përditshmërinë e burrave dhe djemve -përfshirë këtu mospërputhjet, tensionet dhe rezistencat.

Janë pikërisht marrëdhëniet praktike të burrave dhe djemve me imazhet kolektive dhe modelet e maskulinitetit, më shumë se sa reflektimet e thjeshta të tyre, që cilat janë qenësore në të kuptuarit e pasojave të gjinizuara në dhunë, shëndeti dhe edukim. Kjo ka qenë e dukshme që prej formulimit të idesë që krimet e ndryshme përdoren nga burra të ndryshëm në krijimin e maskuliniteteve të bërë nga Messerschmidt (1993). Collier e konsideron këtë ide si të papranushme dhe e sheh ose si të panevojshme, dhe universalizuese ose tepruar në atë që shpjegon. Por nuk ka asgjë befusuese në idenë që praktika të ndryshme krijohen nga shabllone të përbashkëta kulturore; nuk ka asgjë konceptualisht universalizuese në idenë e maskulinitetit hegjemonik. Koordinimi dhe rregullimi ndodhin në praktikat e gjalla shoqërore të kolektiviteteve, institucioneve dhe shoqërive në tërësi. Koncepti i maskulinitetit hegjemonik nuk është menduar si ndonjë parullë ose kauzë primare; ai është një mjet i cili shërben për të kuptuar një dinamikë të caktuar përbrenda një procesi shoqëror.

Subjekti maskulin

Autorë/e të ndryshëm/me kanë argumentuar se koncepti i maskulinitetit hegjemonik është i bazuar mbi një teori jo të kënaqshme të subjektit. Wetherell dhe Edley (1999) e kanë zhvilluar këtë kritikë nga këndvështrimi i psikologjisë diskursive, duke argumentuar se maskuliniteti hegjemonik nuk mund të kuptohet si një strukturë e mirëformuar e karakterit të asnjë grupi të burrave. Ne duhet të pyesimse "si i përshtaten burrat një ideje dhe shëndrrohen në bashkëfajtorë dhe rezistues në raport me atë ide, edhe pse asnjëri nuk arrinë kurrë të mishërojë në plotni atë ideal" (p. 337).

Wetherell dhe Edley (1999) sugjerojnë se ne duhet t'i kuptojmë normat hegjemonike si definuese të pozitës së subjektit në diskurs që përvetësohet në mënyrë strategjike nga burrat nën rrethana të caktuara. Maskuliniteti hegjemonik ka shumë kuptime, gjë që shumë autorë/e e kanë shtjelluar si kritikë por që Wetherell dhe Edley e marrin një pikënisje pozitive. Burrat mund manovrojnë mes këtyre kuptimeve të shumta varësisht nevojave të tyre ndërvepruese. Burrat mund të përvetsojnë maskulinitetin hegjemonik kur është e përshtatshme për ta; por të njëjtit burra mund ta distancojnë strategjikisht veten nga maskuliniteti hegjemonik në momente tjera. Rrjedhimisht, "maskuliniteti" përfaqëson jo vetëm një lloj të burrit por në fakt, mënyrën se si burrat e pozicionojnë vetën përmes praktikave diskursive.

Whitehead (2002, 93) argumenton se koncepti i maskulinitetit hegjemonik mund të "shoh" vetëm strukturë, duke e bërë subjektin të padukshëm: "Individi humb përbrenda, ose në terma llthuzarian, i nënshtrohet një aparatusi ideologjik dhe çytje të lindur për pushtet". Për Whitehead, koncepti dështon të specifikojë se si dhe pse disa burra heteroseksualë legjitimojnë, riprodhojnë dhe gjenerojnë dominimin e tyre dhe e bëjnë këtë duke qenë një minoritet shoqëror në raport me gratë dhe burrat tjerë. Si pasojë, përdorimi i konceptit rezulton "në turbullimin dhe ngatërrimin e maskuliniteteve fluide me strukturën e përgjithshme në "dinamika abstrakte strukturore" (Whitehead 2002, 93 - 94). Për Whitehead është e udhës përqendrimi në diskursin si mjet përmes të cilit burrat njohin veten, ku praktikojnë "të bërit e identitetit" dhe të ushtrojnë pushtet dhe rezistencë gjinor.

Një kritikë e ngjajshme vjen nga psikoanaliza. Sipas kësaj perspektive, modeli i maskulinitetit hegjemonik supozon një subjekt të unisuar mirëpo një trajtim më i thellë psikologjik shpërfaqë një subjekt me shumë shtresa ose një subjekt të ndarë (Collier 1998; Jefferson 1994). Jefferson (2002) kritikon qasjen që thekson "pikëpamjen e tej-shoqërizuar të subjektit në studimet mbi maskulinitetin, që ka rezultuar në mos - trajtim të duhur të asaj se si burrat lidhen psikologjikisht me maskulinitetin hegjemonik. Marrë parasysh maskulinitetet e shumëta, Jefferson argumenton se hulumtuesit duhet të pyesin se "si burrat me biografite veçanta dhe formime psikike specifike ndërlidhen me maskulinitete të ndryshme (p.73). Jefferson sugjeron se burrat dhe djemtë zgjedhin ato qëndrime diskursive që iu ndihmojnë të menaxhojnë ankthin dhe t'u shmangen ndjenjës së pafuqisë.

Argumenti i shtruar nga psikologjia diskursive është pranuar dhe integruar në një qasje të fryshme hulumtuese.. Një shembull i mirë i kësaj është studimi i Lea dhe Auburn (2001) i storjes së një përdhunuesi në një program për dhunues seksualë që tregon se si dhunuesi lëvizë ndërmjet ideologjive konfliktuoze të kontaktit seksual në atë mënyrë që largon përgjegjësinë e përdhunimit nga vetja. Një tjetër shembull është eksplorimi i diskursit identitar të një djali të ri musliman në Angli të Archer (2001), i cili tregon se si ai përdorë një model specifik të maskulinitetit hegjemonik, atë të patriarkut të fuqishëm për të pozicionuar veten në raport pushteti me burrat Afro - karibien, burrat e bardhë dhe burrat muslimanë. Nga kjo ndërmarrje, ne mund të mësojmë jo vetëm se si maskulinitetet janë të krijuara përmes diskursit mirëpo edhe si ato përdoren në diskurs. Specifikisht, ne mësojmë se si versionet hegjemonike lokale të maskulinitetit mund të përdoren për të promovuar vetërespekt në raste të diskreditimit, për shembull, nga nënçmime raciste.

Perspektivat diskursive theksojnë dimensionin simbolik, ndërsa maskuliniteti hegjemonik është formuluar përbrenda të kuptuarit shumëdimensional të gjinisë. Ndonëse çdo specifikim i

maskulinitetit hegjonik zakonisht nënkupton formulim të idealeve kulturore, nuk do duhej të shihet vetëm si normë kulturore. Marrëdhëniet gjinore gjithashtu janë të ndërtaura përmes praktikave jodiskursive, siç është puna me rrogë, dhuna, seksualiteti, punët e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijë gjithashtu si dhe përmes veprimeve tjera rutinore të mekanizuara.

Njohja dimesioneve jodiskursive të gjinisë dhe atyre të mekanizuara na qartëson deri diku limitet e fleksibilitetit diskursiv. Se ekzistojnë këto limite, na e dëshmon fuqishëm Rubin (2003) përmes studimit të tij mbi burrat transeksualë. Njeriu nuk është i lirë të marrë çfarëdo pozicioni gjinor thjeshtë si lëvizje diskursive apo reflektive. Mundësitë të kufizuara në masë të madhe nga mishërimi, historitë institucionale, forcat ekonomike si dhe nga marrëdhëniet familjare dhe ato personale. Kufizimet mund të burojnë edhe nga vetë personi. Të anketuarit e Rubin (2003) veprojnë siç veprojnë dhe i vuajnë pasojat e atyre veprimeve, për shkak të besimit të palëkundur se janë burra, pavarësisht se jetën e kanë filluar në trupa femëror dhe janë rritur si vajza. Ata janë të bindur se janë subjekte të unisuar edhe pse e jetojnë një kontradiktë që duket se ilustron arugmentin e Jefferson (1994, 2002) për subjektin e ndarë. Ne pajtohemi me Jefferson se praktika dhe teoria psikoanalitike është e nevojshme për të kuptuar çështjen komplekse të praktikës gjinore. Ndonëse qasja psikoanalitike e Jeffersoni-t specifikisht nuk është pa probleme (Messerschmidt 2005) është e rëndësishme të njohim pasurinë dhe diversitetin në traditën psikoanalitike. Qasjet ekzistenciale psikoanalitike sikur ato të Sarrit janë të dobishme për të kuptuar maskulinitetin si projekt dhe identitetin maskulin si gjendje e përkohshme që vazhdimisht ndryshon përgjatë jetës. Psikonaliza adleriane e cila thekson pasojat emocionale të marrëdhënive të gjinizuara të pushtetit në fëmijëri, i dha jetë idesë së 'protestës maskuline' që ende rezonon në diskutimet bashkëkohore mbi rininë e margjinalizuar.

Koncepti i maskulinitetit hegjonik në gjenezë është formuluar me një vetëdije të lartë mbi argumentet psikoanalitike rreth karakteristikave të shumfishta dhe kontradiktore të personalitetit, kontestimet ditore në jetën shoqërore dhe gërështimin e strategjive, të nevojshme për të mirëmbajtur hegjoninë (Carrigan, Connell dhe Lee 1985; Connell 1987). Është gjithashtu ironike se si koncepti kritikohet sepse tejthjeshtëzon subjektin, megjithatë është e vërtetë, se shpesh herë koncepti është përdorur në forma të thjeshtëzuara.

A e zhdukë koncepti domosdoshmërisht subjektin? Ne nuk pajtohemi me pohimin Whitehead (2002) se koncepti i maskulinitetit hegjonik redukton në determinizem strukturor. Maskuliniteti është i ndërtaur si trajtë e praktikës e organizuar në raport me stukturën e marrëdhënive gjinore. Praktikrat shoqërore midis njerëzve krijojnë marrëdhënie gjinore përgjatë historisë. Koncepti i maskulinitetit hegjonik përfshinë një këndvështrim historikisht dinamik mbi gjininë, në të cilën është e pamundur të zhduket subjekti. Për këtë, studimet mbi përjetimet jetësore janë kthyer në zhanër karakteristik i punën mbi maskulinitetin hegjonik.

Koncepti homogjenizon subjektin vetëm atëherë kur e redukton atë në një dimension të vetëm të marrëdhënive gjinore (zakonisht atë simbolik) dhe atëherë kur trajtohet si specifikim i një norme. Në momentin kur njeh shumëdimensionalitetin e raporteve gjinore (Connell 2022) dhe shfaqjen e tendencave për krizëkrizë (Connell 1995), është e pamundur ta trajtosh subjektin përbrenda atyre marrëdhënive sikur diçka të unisuar. Gjithësesi, ka mënyra të ndryshme për të kuptuar mospërputhjet e subjektit. Gjuha konceptuale e poststrukturalizmit është një ndër mënyrat për ta bërë atë; psikonaliza dhe modeli i agjencisë përbrenda stukturave shoqërore mundësojnë mënyrat tjera.

Modeli i marrëdhënieve gjinore

Në teoritë shoqërore mbi gjininë, ekziston një tendencë të shkohet drejt funksionalizmit, që nënkupton trajtimin e marrëdhënieve gjinore si diçka të vetë-kontrollueshme, sistem që vetëriprodhohet dhe shpjegues të çdo elementi në terma të funksionit për riprodhimin e sistemit si tërësi. Hawkesworth (1997) e detekton këtë tendencë në teoritë më moderne mbi gjininë. Gjithashtu intervenimi i Bourdieu (2001) në shpjegimin e dominimit maskullor i ka dhënë më shumë hov funksionalizmit në analizën gjinore.

Dominimi i burrave dhe nënshtrimi i grave konstituojnë proces historik dhe jo një sistem që vetëriprodhohet. "Dominimi maskulin" mund të sfidohet dhe kërkon përpjekje të konsiderueshme për t'u mirëmbajtur. Edhe pse kjo ide veçse është trajtuar në shtjellimet e mëhershme të konceptit të maskulinitetit hegjemonik, nuk është thjeshtë vetëm një ide teorike. Mbrapa saj qëndron një punë e detajizuar që dëshmon për taktikat e mirëmbajtjes përmes përjashtimit të grave, duke filluar nga puna e Bird (1996) mbi shoqërimet midis burrave deri tek hulumimet mbi organizimin të Collinson, Knights dhe Collinson (1990), Cockburn (1991) dhe Martin (2001).

Ekzistojnë shumë dëshmi se maskuliniteti hegjemonik nuk është një formë që riprodhohet vetë, qoftë përmes habitusit apo përmes ndonjë mekanizmi tjetër. Për të mirëmbajtur një praktikë të caktuar të hegjemonisë kërkohet policimi i burrave dhe përjashtimi apo zhvlerësimi i grave. Dëshmi të këtyre mekanizmave mund të gjenden në opsionet "e buta" të zhvlerësimit në botën e vrazhdtë të marrëdhënieve ndërkombëtare, kërcënimeve të sigurisë dhe luftës (Hooper 2001), sulmeve homofobike, vrasjeve (Tomsen 2002) e deri tek përqeshja e djemve në shkollë për shkak se janë shumë frikacak (Kimmel dhe Mahler 2003; Messerschmidt 2000).

Në kritikën e Demetriou (2001) mbi maskulinitetin hegjemonik njihet historiciteti i gjinisë. Megjithatë, Demetriou, sygjeron se këtu kemi të bëjmë një tjetër formë të thjeshtëzimit. Ai identifikon dy forma të hegjemonisë, asaj të brendshme dhe të jashtme. Hegjemonia e jashtme i referohet institucionalizimit të shtypjes së grave prej burrave, hegjemonia e brendshme i referohet lartësimit shoqëror të një grupi burrash mbi të gjitha burrat tjerë. Demetriou argumenton se ndërlihdja midis të dy formave është ende e paqartë në formulimin fillestarë të konceptit dhe i paspecifikuar në përdorimet e sotshme. Për më tepër, hegjemonia e brendshme zakonisht është kuptuar në terma elitistë. Kjo nënkupton se, maskulinitetet e nënshtruara dhe të marginalizuara nuk kanë ndikim në krijimin e maskulinitetit hegjemonik. Maskulinitetet johegjemonike veprojnë në tension me, por kurrë nuk arrijnë të depërtojnë apo të ndikojnë në maskulinitetin hegjemonik. Kësajsoji edhe krijohet një përfaqësim dualistik i maskulinitetit.

Ky konceptualizim sipas Demetriou (2001) dështon ta kapë "pragmatizimin dialektik" të hegjemonisë së brendshme, përmes së cilës maskuliniteti hegjemonik përvetëson nga maskulinitetet tjera çfarëdo që duket si e dobishme për të mirëmbajtur dominimin. Rezultati i kësaj dialektike nuk është një model i njëtrajtshëm e maskulinitetit hegjemonik por një 'bllok historik' ku gërshetohen modele të shumta, hibriditeti i së cilave është strategjia më e mirë e mundshme për hegjemoninë e jashtme. Pra, një proces i vazhdueshëm i negocimit, përshtatjes dhe rikonfigurimit paraqitet.

Një konceptualizim i tillë çonë drejt këndvështrimit tjetër mbi ndryshimet historike mbi maskulinitetet. Maskuliniteti hegjemonik nuk i përshtatet thjeshtë vetëm kontradiktave historike. Në fakt, blloku i maskulinitetit hegjemonik është një hibridizim, përvetësimi i elementeve të ndryshme të së cilës e mundëson rikonfigurimin e vetës dhe përshtatjen përbrenda specifike të

ndodhive të reja historike (Demetriou 2001, 355). Si shembull i këtij procesi, Demetriou (2001) e diskuton dukshmërinë kulturore në rritje të maskulinitetit gej në shoqëritë perendimore. Kjo ka mundësuar përvetësim të stilit dhe praktikave të burrave gejë nga burrat heteroseksualë për të krijuar kështu trajta të reja hibride të praktikës gjinore. Këto përvetësime turbullojnë dallimet midis gjinive mirëpo asesi nuk e dobësojnë patriarkatin.

Konceptualizimi i Demetriou-s (2001) i pragmatizmit dialektik në "hegjemoninë e brendshme" është i dobishëm dhe ai paraqet një shembull bindës se disa shpërfaqje të maskulinitetit dhe disa nga praktikatat e përditshme gjinore të burrave heteroseksualë kanë përvetësuar disa nga karakteristikat e maskulinitetit gej. Është e qartë se disa praktika maskuline specifike mund të përvetësohen përbrenda maskuliniteteve tjera duke krijuar një hibrid (si për shembull përvetësimi i stilit dhe gjuhës së muzikës hip - hop nga disa djem të bardhë të klasës punëtore dhe stili unik i "kloneve" gejë). Megjithatë, ne nuk jemi bindur se ky gërshtëtim që Demetriou (2001) përshkruan është hegjemonik, të paktën përtej termave lokalë. Edhe pse maskuliniteti dhe seksualiteti gej dita ditës po bëhet me i dukshëm në shoqëritë perendimore, është e çuditshme magjepsja që ndodhë kur ka një karakter televiziv që është gej si për shembull në programet Six Feet Under, ëill and Grace, dhe Queer Eye for the Straight Gay, - ka pak arsye të mendohet se ky hibridizim është bërë hegjemonik në nivelin rajonal dhe global.

Koncepti i një blloku hegjemonik sjellë në pah çështjen e shumësisë maskuliniteteve hegjemonike . Jefferson (2002, 71) dhe të tjerë kanë kritikuar tendencën për të trajtuar vetëm një model - maskuliniteti hegjemonik gjithmonë referohet si njëjës. Kjo është paradoksale. Duke qenë të gjitha gjetjet etnografike kanë treguar kultura të veçanta të gjinisë, tregimet mbi jetën e përditshme zbulojnë trajektore të veçanta të jetës së burrave dhe çdo analizë strukturore definojnë ndërthurje të reja midis racës, klasës, gjinisë dhe gjeneratave, është logjikisht e mundur që të definojnë njëmijë e një variacione të maskulinitetit (Meuser dhe Behnke 1998). Kjo gjithashtu qëndron si e vërtetë tek pretenduesit e hegjemonisë. Ky qëndrim është i mbështetur fuqishëm edhe në hartëzimin e politikave mbi maskulinitetin në Amerikë të bëtë Messner (1997), i cili shpërfaq një sërë lëvizjesh të ndryshme me agjenda të kundërta. Megjithatë, nëse analizohen më afër, këto lëvizje përfaqësojnë një mënyrë se si burrat duhet të mendojnë dhe jetojnë. Përkundër diversitetit empirik të maskuliniteteve, kontestimi për hegjemoni tregon se hierarkia gjinore nuk ka disa pozita fikse në krye. Do t'i rikthehem kësaj çështjeje, pasi që është tejet e rëndësishme për t'i kuptuar politikatat gjinore.

RISHIKIMI DHE RIFORMULIMI

Tani ne i përmbledhim këto diskutime për të sugjeruar atë se si do duhej të riformulohet koncepti i maskulinitetit hegjemonik. Ne do t'i trajtojmë karakteristikat e konceptit origjinal të cilat i kanë bërë ballë hulumtimit dhe kritikës, ato që do duhej të largohen dhe ato pjesë ku koncepti ka nevojë për riformulim bashkëkohor.

Çka duhet të ruhet

Karakteristika bazë e konceptit mbetet kombinimi i pluralitetit të maskulinitetit dhe hierarkisë së maskuliniteteve. Kjo ide bazike i ka qëndruar mirë 20 viteve hulumtime të bëra. Modele të shumëta të maskulinitetit janë identifikuar në shumë studime, shtete të ndryshme dhe në hapësira të ndryshme institucionale dhe kulturore. Është gjithashtu një gjetje e ënjohur ajo se disa maskulinitete janë të bazuara më shumë në shoqëri apo janë më shumë të asociuar me autoritet dhe pushtet shoqëror, sesa disa të tjerë. Koncepti i maskulinitetit hegjemonik presupozon

nënshtrimin e maskuliniteteve jo hegjemonike, dhe ky proces është i dokumentuarr tashmë në shumë hapësira ndërkombëtarisht.

E mirëmbështetur është gjithashtu ideja që hierarkia e maskuliniteteve është një model i hegjemonisë dhe jo një model i dominimit të thjeshtë të bazuar në forcë. Pëlqimi kulturor, qëndralizimi diskursiv, institucionalizimi dhe margjinalizimi apo deligjitimimi i alternative tjera janë dokumentuar gjerësisht të jenë karakteristika të maskuliniteteve shoqërore dominante. Gjithashtu, mirë e mbështetur është ideja se maskuliniteti hegjemonik nuk duhet të jetë modelime i përhapur në përditshmërinë e djemve dhe burrave. Hegjemonia në fakt funksionon pjesërisht duke ofruar shembuj të maskulinitetit si për shembull kampionë të sporteve profesionale), për të shërbyer si simbole që kanë autoritet, edhe pse shumica e djemve dhe burrave nuk përkojnë me këtë standard.

Formulimet fillestare kanë theksuar mundësinë për ndryshim në marrëdhëniet gjinore, duke u bazuar në premisën se modelet dominante të maskulinitetit janë të hapura ndaj ndryshimit, prej rezistencës e grave ndaj patriarkatit, deri tek burrat si bartës të maskuliniteteve alternative. Hulumtimet kanë konfirmuar krijimin dhe rikrijimin historik të maskuliniteteve hegjemonike. Edhe në nivel lokal dhe nivel mbarëshoqëror, kontekstet ku janë ndërtuar maskulinitetet kanë ndërruar ndër kohë. Këto ndryshime ftojnë për krijim të strategjive të reja në marrëdhënie gjinore (p.sh bashkëjetesa) që rezultojnë në ridefinim të maskulinitetit që adhurohet nga shoqëria (p.sh preferenca e një partneri familjar sesa një patriarku viktorian).

Çka duhet refuzuar

Dy nga aspektet e artikuluara nga konceptimi i hershëm i maskulinitetit hegjemonik nuk i kanë bërë ballë kritikës dhe duhet zhbërë. I pari është modeli i tejthjeshtëzuar imarrëdhënieve shoqërore përkritazi me maskulinitetet hegjemonike. Artikulimet në esenë *Gjinia dhe Pushteti* kanë tentuar të lokalizojnë të gjitha maskulinitetet (dhe të gjitha feminitetet) në terma të një modeli të vetëm të pushtetit, "dominimit global" të burrave ndaj grave (Connell 1987, 183). Edhe pse kjo ishte e dobishme në atë kohë për të parandaluarqë ideja e maskuliniteteve të shumfishta të shëndërrohej në një garë midis mënyrave të jetesës, kjo tashmë është e papërshtatshme për të uptuarit tonë të raporteve mes grupeve të burrave e dhe formave të maskulinitetit dhe marrëdhënien e grave me maskulinitetet dominante. Për shembull, dominimi në marrëdhënie gjinore nënkupton një ndërveprim të pasojave dhe përfitimeve, kundërshtitë ndaj maskulinitetit hegjemonik vijnë ngë maskulinitetet revoltuese të grupeve etnike të margjinalizuara dhe gratë borgjeze mund të përvetësojnë aspekte të maskulinitetit hegjemonik për të ndërtuar karrierë profesionale ose karrierë në korporata. Qartësisht, nevojiten mënyra më të mira për ta kuptuar hierarkinë gjinore..

Përkundër kritikës së psikologjisë së tipareve në *Gjinia dhe Pushteti*, dhe lavdërimi i qëndrimit psikoanalitik për motivet e pavetëdijëshme, artikulimet fillestare sa i përket maskulinitetit hegjemonik tekso tentonin të qartësojnë përmbatjetjen e konfigurimeve të ndryshme të maskulinitetit, u kthyen prapë në terminologjinë e tipareve ose në rastin më të mirë dështuan të ofrojnë një alternativë saj. Nocioni i maskulinitetit si një gërshëtim tiparësh i hapi rrugë trajtimit të maskulinitetit hegjemonik si tip i ngulitur i karakterit duke shkaktuar kështu shumë probleme dhe me të drejtë është kritikuar nga shkrimet e fundit në psikologji. Jo vetëm esencjalizimi i konceptit të maskulinitetit por gjithashtu në terma të pëgjithshëm, qasja e bazuar në tipare ndaj gjinisë duhet të tejkalohet.

Çka duhet të riformulohet

Nën dritën e hulumtimit dhe kritikës të lartëpërmendur, ne argumentojmë se koncepti i maskulinitetit hegjemonik ka nevojë për një riformulim në katër çështje kryesore: natyra e hierarkisë gjinore, gjeografia e trajtave maskuline, procesi shoqëror i mishërimit, dhe dinamikat e maskuliniteteve. Në vazhdim, do të ofrojmë një linjë të mendimit dhe disa sugjerime për hulumtim rreth këtyre katër çështjeve.

Hierarkia gjinore

Krahasuar me formulimet fillestare të konceptit, hulumtimet bashkëkohore kanë shpërfaqur kompleksitetin e marrëdhënieve midis sajësive të ndryshme të maskulinitetit. Hulumtimet më të reja në psikologjinë diskursive sugjerojnë se sajësat e ndryshme të maskulinitetit në nivelin lokal mund të shërbejnë si alternativa taktike. Marrëdhëniet e strukturuar midis maskuliniteteve ekzistojnë në të gjitha kontekstet lokale dhe këto versione lokale padyshim se dallojnë midis vete. Nocioni i Demetriou (2001) mbi pragmatizimin dialektik kapë ndikimin reciprok që maskulinitetet kanë në njëri-tjetrin; maskulinja hegjemonike mund të ndryshojë duke përvetësuar elemente nga të tjerët.

Së fundmi analizat mbi marrëdhëniet midis maskuliniteteve në mënyrë më të qartë njohin agjencinë e grupeve të marginalizuara dhe të nënshtruara, shpesh të kushtëzuara nga vendndodhjet e tyre specifike (siç do të diskutohen më poshtë). Maskuliniteti revoltues (Poynting, Noble dhe Tabar 2003) mund të kuptohet në këtë kuptim; një praktikë e maskulinitetit e krijuar në hapësira lokale të klasës punëtore, ndonjëherë mes burrave etnikë të marginalizuar të cilët mishërojnë pretendimin për pushtet, tipike e maskuliniteteve hegjemonike rajonale të vendeve perendimore por që funksionon me mungesë të burimeve ekonomike dhe institucionale që përforcon praktikat rajonale dhe globale.

Hulumtuesit/et gjithashtu kanë dokumentuar qëndrueshmërinë apo jetëgjatësinë e praktikave të maskulinitetit johegjemonik, i cila mund të përfaqësojë një përgjigje të mirë konsoliduar kundrejt marginalizimit racor/etnik, diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuar, pabarazisë klasore ose stigmatizimit të seksualiteteve. Hegjemonia mund të arrihet përmes përfshirjes së këtyre maskuliniteteve brenda një rendi gjinor funksional dhe jo duke i shtypur në mënyrë aktive përmes diskreditimit ose dhunës. Në praktikë, përfshirja dhe shtypja mund të bashkekzistojnë. Kjo është gjendja tek komuniteti bashkëkohorë geje në qendrat urbane të Perëndimit, ku komunitetet geje kanë një mori përvojash duke filluar nga dhuna homofobike, denigrimi kulturor deri tek toleranca, lavdërimi dhe përfaqësim politik. Procese të ngjashme të përfshirjes dhe shtypjes mund të ndodhin edhe tek gratë dhe vajzat që krijojnë maskulinitete (Messerschmidt 2004).

Koncepti i maskulinitetit hegjemonik është formuluar në gjenezë së bashku me një koncept të feminitetit hegjemonik, për t'u riemëruar shpejtë si 'feminiteti i theksuar' për të njohur pozicionimin asimetrik të maskuliniteteve dhe feminiteteve në rendin gjinor patriarkal. Përgjatë hulumtimeve mbi burrat dhe maskulinitetet, kjo marrëdhënie është larguar nga fokusi. Kjo është e trishtë për disa arsye. Gjinia gjithmonë ekziston përmes marrëdhënieve dhe praktikave të maskulinitetit janë të definuara në kontradiktë me ndonjë model (qoftë ai i real apo imagjinar) i feminitetit.

Ndoshta edhe më e rëndësishme,, fokusimi vetëm në aktivitetet e burrave, nuk përfshinë praktikave të grave në ndërtimin e gjinisë mes burrave. Siç është dëshmuar përmes hulumtimit mbi tregimet e jetës, gratë janë qendrore në shumë prej proceseve të bërjes së maskuliniteteve - si nëna, shoqe

të klasës, si të dashura, partnere seksuale dhe bashkëshkorte; si punëtore në ndarjen gjinore të punës e kështu me radhë. Koncepti i feminitetit të theksuar fokusohet në pajtushmërinë e grave me patriarkatin dhe kjo është ende tejet relevante në kulturën bashkëkohore të masës. Megjithatë, hierarkitë gjinore janë të ndikuara nga trajtat e reja të identiteteve dhe praktikave të grave, specifikuat tek gratë e reja, të cilat dita-ditës po njihen më shumë nga burrat e rinj. Ne konsiderojmë se hulumtimi mbi maskulinitetin hegjemonik tash ka nevojë t'i ofrojë më shumë vëmendje praktikave të grave dhe ndërveprimit historik mes maskuliniteteve dhe feminiteteve.

Kështu, ne sygjerojmë se të kuptuarit tonëmbi maskulinitetin hegjemonik duhet të përfshijë një kuptim më holistik të hierarkive gjinore, duke njohur agjencinë e grupeve të nënshtruara, në të njëjtën kohë duke njohur pushtetin e grupeve dominante dhe se si këto kushtëzojnë njëra - tjetrën në dinamikat gjinore dhe dinamikat tjera shoqërore. Ne konsiderojmë se kjo do të ndihmojë që në ndërkohë të reduktohet izolimi në të cilin gjinden studimet mbi burrat dhe do të theksojë rëndësinë e dinamikave gjinore në trajtim të problemeve të ndryshme në shkencat shoqërore duke filluar nga efektet e globalizimit, çështjet e dhunës dhe paqebërjes.

Gjeografia e maskuliniteteve

Ndryshimet në krijimet lokale të maskulinitetit hegjemonik kanë qenë temë kyçe në hulumtimet e dy dekadave të fundit. Por me kthimin e vëmendjes drejt globalizimit, është sfiduar rëndësia e hapësirave transnacionale në ndërtimit të maskulinitetit. Hooper (1998, 2000) përshkruan vendosjen e maskulinitetit hegjemonik dhe maskulinitetet tjera në hapësirat e marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe Connell (1998) propozoi një model të 'maskulinitetit transnacional të biznesit' i cili është i përhapur tek drejtorët e korporatave dhe që ndërlidhet me agjendat neoliberale të globalizimit.

Çështjet se a anashkalojnë këto procese dinamikat gjinore lokale dhe rajonale dhe deri në çfarë mase është ende çështje që është duke u diskutuar. Pease dhe Pringle (2001) në një përmbledhje ndërkombëtare, argumentojnë për në favor të vazhdimit të përqendrimit të analizës në të kuptuarit emaskuliniteteve në terma rajonal dhe krahasues. Në më të paktën, ne duhet ta kuptojmë se artikujt rajonale dhe lokale të maskulinitetit hegjemonik janë të kushtëzuara nga artikujt i sistemeve gjinore në raport me proceset globale. Në këtë linjë, Kimmel (2005) rishtazi ka analizuar se si efektet e maskulinitetit hegjemonik global janë të mishëruara në shpërfaqjen e maskuliniteteve revoltuese rajonale (supremacistët e bardhë në Shtetet e Bashkuara dhe Suedi) dhe ato globale (Al Quaeda në Lindjen e Mesme).

Ne konsiderojmë se këto çështje janë tashmë të pashmangshme në studimet mbi maskulinitetin dhe sugjerojmë një kornizë të thjeshtë studimi në vijim. Maskulinitetet hegjemonike të cilat janë empirikisht ekzistente mund të analizohen në tri nivele:

1. Niveli lokal; të ndërtuara në hapësira ku ka kontakt të drejtpërdrejtë si për shembull brenda familjes, organizimeve dhe komunitete të aferta, siç rëndom i hasim në hulumtimet etnografike dhe në hulumtimet që merren me historitë jetësore.

2. Niveli rajonal: i ndërtuar në nivel kulture ose kombi - shteti, rëndom haset në hulumtime diskursive, politike dhe demografike; si dhe

3. Niveli global: i ndërtuar në hapësira transnacionale si për shembull politikat ndërkombëtare, bizneset dhe mediat transnacionale, siç studiohen në hulumtimet në rritjemi maskulinitetit dhe globalizmin.

Jo vetëm që ekzistojnë lidhje midis niveleve; por ato lidhje mund të jenë edhe të rëndësishme në politikën gjinore. Institucionet globale kanë ndikim në rendin gjinor lokal dhe global; përderisa rendi gjinor rajonal ofron material kulturor i cili përshtatet ose përpunohet në hapësira globale, ai ofron edhe modele të maskulinitetit të cilat mund të jenë të rëndësishme në dinamikën gjinore lokale.

Le të trajtojmë specifikisht marrëdhënien midis maskulinitetit rajonal dhe lokal. Maskuliniteti hegjemonik në nivelin rajonal përfaqësohet në mënyrë simbolike si ndërveprim i praktikave specifike lokale të maskulinitetit por që kanë rëndësi rajonale, si për shembull si praktikën e aktorëve të filmave artistik, atletëve profesionalë dhe politikanëve. Përmbajtja e këtyre praktikave ndryshon përgjatë kohës dhe nëpër shoqëri të ndryshme. Megjithatë maskuliniteti hegjemonik rajonal përkufizon kuptimin e shoqërisë mbi realitetin e maskulinitetit, kështu ai funksionon përmes një domeni kulturor si material i dorës së parë që kërkon aktualizim, ndryshim apo sfidim përmes praktikave në kontekste të ndryshme lokale. Kësisoj, një maskulinitet hegjemonik rajonal ofron një kornizë kulturore e cila mund të materializohet në praktika dhe ndërveprime ditore.

Si ilustrim i këtij ndërveprimi mes maskulinitetit hegjemonik rajonal dhe lokal, kini parasysh sportin. Në shoqëritë perendimore, praktikën në nivelin lokal siç është ajo e angazhimit në ngjarje sportive profesionale ndërton modele të maskulinitetit hegjemonik (si psh yjet atletikë) në nivelin rajonal, gjë që për rrjedhojë ka ndikim në hapësira lokale. Hulumtimet mbi shkollimin dytësor ofrojnë një shembull të këtij paradigmi, duke treguar pjesëmarrja e suksesshme në sporte është rëndom praktikë e dukshme e maskulinitetit hegjemonik në këtë hapësirë lokale specifike (Messner 2022). Për shembull, Light dhe Kirk (2000) analizojnë një shkollë të mesme elitare australiane në të cilën një lloj i caktuar i maskulinitetit hegjemonik ka marrë formë përmes mishërimit të futbollit rugby, kodifikimi i të cilit gjithsesi se nuk është i kufizuar vetëm në këtë shkollë, ai është i bazuar në dominim, agresion, konkurrencë të pamëshirshme dhe gatishmërinë që studentët t'i japin të gjitha për shkollën. (Gjetje të ngjajshme kanë ofruar edhe Burgess, Edwards dhe Skinner 2003). Kështu, eksemplarët e dukshëm rajonalë të modeleve maskuline ndikojnë, edhe pse jo në plotni, në ndërtimin e marrëdhënieve gjinore dhe maskuliniteteve hegjemonike në nivelin lokal.

Edhe pse është e natyrshme të supozosh një hierarki të thjeshtë e cila është e bazuar në pushtet dhe autoritet, duke filluar nga niveli global, ai rajonal deri tek ai lokal, kjo megjithatë mund të jetë ç'orientuese. Në diskutimet mbi globalizimin, pushteti determinues i globales shpeshherë është i mbivlerësuar, përderisa rezistenca dhe kapaciteti i asaj që ne po e quajmë rajonale mbetet e panjohur (Mittelman 2004). Hulumtimet e pakta që janë kryer deri më tani mbi maskulinitetin në hapësira globale (psh Connell dhe Hood 2005, Hooper 2001) nuk sugjerojnë një formulim të fortë i cili mund të minojë kapacitetet e maskuliniteteve rajonale apo lokale. Megjithatë, dëshmitë mbi dinamikën globale gjinore janë në rritje, dhe është e qartë se proceset si ristrukturimi i ekonomisë, migrimet në largësi të mëdha dhe turbulenca e agjendave "zhvillimore" kanë pushtetin të riformësojnë praktikën lokale të feminitetit dhe maskulinitetit (Connell 2005; Morrell dhe Swart 2005). Të gjitha dëshmitë aludojnë se ndërveprimet në lidhje me maskulinitetin global do të kenë më shumë ndikim në politikën gjinore dhe kjo çështje do duhej të ishte kyçe në hulumtimet e ardhshme mbi hegjemoninë.

Aplikimi i një kornize analitike që veçon maskulinitetet (duke përfshirë edhe feminitetet) lokale, rajonale dhe globale na mundëson të njohim rëndësinë e lokaliteteve pa kaluar në një perspektivë monadike ku ekzistojnë vetëm diskurse dhe kultura totalisht të pavarura. Gjithashtu, ajo e qartëson çështjen e shumësisë së maskuliniteteve hegjemonike të cekur më lartë. Edhe pse modelet lokale të maskulinitetit hegjemonik mund të kenë dallojnë nga njëri-tjetri, ato rëndom janë të mbivendosuna mbi njëri-tjetrin. Bashkëveprimi i tyre me dinamikat gjinore mbarëshoqërore e shpjegon pjesërisht këtë gërshetim. Për më tepër, maskulinitetet hegjemonike, siç kemi argumentuar tashmë, ndërtohen deri në një masë prëmes ndërveprimit të burrave dhe gra, prandaj edhe ngjashmëritë në praktikën e grave prodhojnë gërshetime. Andaj, krijimet lokale të maskulinitetit hegjemonik kanë "ngjashmëri familjare" për ta përdorur termin e ëittgenstein, më shumë sesa identitet logjik. Në këtë kuptim, shumësia lokale është e pajtueshme me maskulinitetin hegjemonik të një trajtshëm të nivelit rajonal apo atë mbarëshoqëror. "Ngjashmëritë e një familje" në mesin e variacioneve lokale zakonisht përfaqësohet nga një model simbolik në nivelin rajonal, jo nga disa sosh.

Mishërimi shoqëror

Që maskuliniteti hegjemonik është i ndërlidhur më mënyra specifike të përfaqësimit dhe shfrytëzimit të trupave të burrave është diçka veçse e njohur që nga formulimet fillestare të konceptit. Megjithatë praktikën e mishërimit që ndodhin në hegjemoni nuk janë të teorizuar në mënyrën më bindëse.

Rëndësia e mishërimit maskulin për identitetin dhe sjelljen shpërfaqet në shumë kontekste. Tek të rinjtë, aktiviteti i trupit të aftësuar bëhet shënjues kryesor i maskulinitetit, siç edhe e kemi parë në fushën e sportit. Kjo është ndër mënyrat kyçe si ndërlidhet heteroseksualiteti dhe maskuliniteti në kulturën perendimore, ku djemtë që kanë partnere heteroseksuale trajtohen me prestigj dhe edukimi seksual imagjinohet si eksplorim dhe pushtim. Praktikën e trupit siç janë ngrënja e mishit dhe ndërmarrja e rreziqeve gjatë vozitjes janë bërë gjithashtu karakteristika që ndërlidhen ngushtë me maskulinitetin. Kjo logjikisht çon në strategji promovuese të shëndetit të cilat funksionojnë përmes ç'gjinizimit -kontestimit të maskulinitetit hegjemonik ose lëvizjes së burrave drejt një drejtimi të bazuar më shumë në androgjini. Megjithatë, vështirësitë në strategjitë ç'gjinizuese pjesërisht vijnë edhe nga çështja e mishërimit, për shembull, vendoshmëria për t'u përfshirë në praktika të caktuara si mënyrë për të krijuar një reputacion maskulin në kontekstin e grupeve të bashkëmoshatarëve.

Leximi dominant i trupave si objekte të krijimit social në shkencat shoqërore, tash është pranuar të jetë joadekuat. Trupat janë të përfshirë në proceset shoqërore në mënyrë më aktive, më intime, më të ndërlidhur se sa ajo që e lejuar kjo teori. Trupat marrin pjesë në aksion shoqëror duke i përvijuar sjelljeve shoqërore - trupi është i përfshirë në prodhimin e praktikave shoqërore. Përveç që është e rëndësishme që maskulinitetet të kuptohen si procese mishërimi, po aq e rëndësishme është që të konsiderohet gërshetimi i mishërimit dhe kontekstit shoqëror.

Nevoja për një trajtim më të sofistikuar të mishërimit të maskulinitetit hegjemonik vjen veçanërisht në pah nga praktikatat transgjinore, të cilat janë shumë vështirë të kuptohen nëse trajtohen vetëm përbrenda një modeli të thjeshtë të krijimit shoqëror. Kjo çështje është riformuluar nga teoria queer, e cila ka trajtuar kalimin nëpër gjini si diçka subversive në raport me rendin gjinor ose të paktën si shënjues i cënueshmërisë së rendit gjinor. Debate të nxehta janë zhvilluar mbi transeskuallizmin, ku disa psikiatër kanë vë në pikëpyetje nëse në fakt gjinia mund të ndryshohet.

Andaj, nuk është e lehtë të trajtosh implikimet e praktikave transgjimore në hegjemoni. Me Rubin (2003) dhe Namaste (2000), ne konsiderojmë se maskulinitetet të cilat janë krijuar në persona transeksual të cilët kanë kaluar nga të qenurit femër në mashkull, përjetimet e tyre jo domosdoshmërisht janë kundër - hegjemonike. Burrat e vetë- bërë mund të luftojnë për barazi gjinore ose ta kundërshtojnë atë, sikur se burrat që nuk janë transeksualë. Çfarë theksojnë përjetimet transeksuale është trajtimi modern i trupit si një medium përmes së cilit vetja ndërvepron me njëri - tjetrin. (Rubin 2003, 180)

Për të kuptuar mishërimin dhe hegjemoninë, ne duhet ta kuptojmë se trupat janë edhe objekte të praktikave shoqërore, edhe agjentë të praktikave shoqërore (Connell 2002). Këtojanë qarqet-që lidhin proceset trupore me strukturat shoqërore dhe të gjitha këto nyje janë pjesë e të gjitha proceseve historike përmes të cilat shoqëritë janë të mishëruara. Këto nyje të mishërimit shoqëror mund të jenë shumë të drejtpërdrejta dhe të thjeshta, ose mund të jenë të gjata dhe komplekse, duke kaluar përmes institucioneve, marrëdhënieve ekonomike, simboleve ekonomike dhe kështu me rradhë - duke mos pushuar së përfshiri trupat materialë. Kjo lehtësisht mund të ilustruhet përmes praktikave gjinore në shëndet, sëmundje dhe trajtimin mjekësor.

Midis grupeve dominuese të burrave, qarqet e mishërimit shoqëror vazhdimisht përfshijnë institucionet të cilat mbështeteshin privilegjet e tyre. Kjo tregohet në mënyrë dramatike në një studim pionier nga Donaldson dhe Poynting (2004) mbi jetën e përditshme të burrave të klasës sunduese. Ky studim tregon, për shembull, se si sportet e tyre karakteristike, koha e lirë, dhe praktikat e të ngrënit tregojnë pasurinë e tyre dhe vendosin marrëdhënie distancim dhe dominimi mbi trupat e burrave të tjerë. Këtu hapet një mundësi për hulumtim, veçanërisht kur marrim parasysh se si teknologjitë e shtrenjta - sistemet kompjuterike, udhëtimi ajror global, komunikimet e sigurtat - përforcojnë fuqitë fizike të trupave të burrave elitare.

Dinamikat e maskulinitetit

Edhe pse e njohur prej kohësh, kompleksiteti i brendshëm i maskuliniteteve vetëm së fundmi është kthyer në çështje hulumtimi. Siç theksohet nga diskutimi ynë i mëparshëm mbi subjektin në praktikën gjinore, tani duhet të njohim shprehimisht shtresëzimin dhe kontradikat e brendshme të mundshme përbrenda të gjitha praktikave që ndërtojnë maskulinitetet. Praktika të tilla nuk mund të lexohen thjesht si shprehje e një maskuliniteti unitar. Ato mund, për shembull, të përfaqësojnë formacione ku ndodhë një kompromis midis dëshirave ose emocioneve kontradiktore ose të vijnë si rezultat i llogaritjeve të pasigurtat në lidhje me kostot dhe përfitimet e strategjive të ndryshme gjinore.

Hulumtimet mbi historitë jetësore kanë vënë në dukje një dinamikë tjetër të maskuliniteteve, strukturën e një projekti. Maskulinitetet janë konfigurime të praktikës që ndërtohen, shpalosen dhe ndryshojnë me kalimin e kohës. Një literaturë e pakët mbi maskulinitetin dhe plakjen dhe një tjetër më voluminoze për fëmijërinë dhe rininë e theksojnë këtë çështje. Një analizë e kujdesshme e përjetimeve jetësore mund të zbulojë angazhime kontradiktore dhe tranzicione institucionale që pasqyrojnë maskulinitete të ndryshme hegjemonike që gjithashtu kanë potencial për të sjellje ndryshim.

Maskulinitetet hegjemonike rëndom përfshijnë modele specifike të dallimeve të brendshme dhe konflikteve emocionale, pikërisht për shkak të lidhjes së tyre me pushtetin e gjinor. Marrëdhëniet me babatë janë një fokus i mundshëm i tensionit, duke pasur parasysh ndarjen gjinore të punës në kujdesin ndaj fëmijëve, "kulturën e orëve të gjata të punës" në profesione dhe menaxhim dhe preokupimi i baballarëve të pasur me menaxhimin e pasurisë së tyre. Ambivalenca ndaj projekteve

të ndryshimit nga ana e grave ka të ngjarë të jetë tjetër, që do të çojë në pranimin dhe refuzimin luhatës të barazisë gjinore nga të njëjtët burra. Çdo strategji për ruajtjen e pushtetit ka të ngjarë të përfshijë dehumanizimin e të tjerëve dhe përcjellur nga një zbehje të ndjeshmërisë dhe lidhjes emocionale me veten (Schäalbe 1992). Pa i trajtuar burrat e privilegjuar si objekt keqardhjeje, ne duhet të pranojmë se maskuliniteti hegjemonik nuk përkthehet domosdoshmërisht në një përvojë e kënaqshme jetësore.

Ndryshimi me kalimin e kohës, ndonëse sigurisht i formësuar nga kontradiktat përbrenda maskulinitetit, mund të jetë gjithashtu i qëllimshëm. Fëmijët si dhe të rriturit kanë aftësinë për të zbrëthyer binaret gjinore dhe për të kritikuar maskulinitetin hegjemonik dhe kjo aftësi është bazë e mirë për shumë ndërhyrje edukative dhe programe të ndryshimit. Në të njëjtën kohë, bartësit e maskulinitetit hegjemonik nuk janë domosdoshmërisht "naivë kulturorë"; ata mund të përipiqen në mënyrë aktive për të modernizuar marrëdhëniet gjinore dhe për të riformësuar maskulinitetet si pjesë e kësaj përpjekjeje. Një shembull i mirë është "menaxhimi i ri publik" në organizatat e sektorit publik të cilat refuzojnë burokracinë e stilit të vjetër dhe besojnë në organizata "më të këndshme", ku ka mundësi të barabarta dhe politika punësimi miqësore për familjen. Megjithatë edhe modernizimi i maskuliniteteve mund të mos zgjidhë problemet. Edhe kjo, siç argumenton Meuser (2001) prodhon kontradikta që mund të çojnë në ndryshime të mëtejshme.

Marrëdhëniet gjinore janë gjithmonë arena tensioni. Një model i caktuar i maskulinitetit hegjemonik është hegjemonik në masën që u jep zgjidhje këtyre tensioneve, me prirje për të stabilizuar pushtetin patriarkal ose për ta rindërtuar atë në kushte të reja. Një praktikë (d.m.th., një version i maskulinitetit) që ka ofruar një zgjidhje të tillë në të kaluarën por jo në kushte të reja, është lehtësisht i sfidueshëm - në fakt është e sigurt se do të sfidohet.

Një kontestim i tillë ndodhë vazhdimisht përmes përpjekjeve të lëvizjes së grave (në nivel lokal, rajonal dhe global), midis brezave në komunitetet e imigrantëve, midis modeleve të maskulinitetit menaxherial, midis rivalëve për autoritetin politik, midis pretenduesve për vëmendje në industrinë e argëtimit, dhe kështu me radhë. Kontestimi është i vërtetë dhe teoria gjinore nuk e parashikon se cila do të mbizotërojë – procesi është i hapur ndaj historisë. Prandaj dhe hegjemonia mund të dështojë. Koncepti i maskulinitetit hegjemonik nuk mbështetet në një teori të riprodhimit shoqëror.

E thënë ndryshe, konceptualizimi i maskulinitetit hegjemonik duhet të pranojë në mënyrë të qartë mundësinë e demokratizimit të marrëdhënieve gjinore, zhbërjes së pushtetit, jo vetëm të riprodhimit të hierarkisë. Një lëvizje kalimtare në këtë drejtim kërkon një përpjekje për të krijuar si hegjemonikë mes burrave ("hegjemonia e brendshme" në kuptimin e Demetriou [2001]) një version të maskulinitetit të hapur ndaj barazisë me gratë. Në këtë kuptim, është e mundur të përkufizohet një maskulinitet hegjemonik që është në masë të madhe "pozitiv" (në kuptimin e Collier [1998]). Historia e re ka treguar vështirësinë për ta bërë këtë në praktikë. Hegjemonia pozitive mbetet, megjithatë, një çelës në strategjinë për reformim në terma bashkëkohor.

Përfundime

Konceptet në shkencat shoqërore lindin si përgjigje ndaj problemeve dhe praktikave specifike intelektuale, dhe ato formulohen në gjuhë të veçanta dhe stile intelektuale. Por ato gjithashtu kanë një aftësi për të udhëtuar dhe mund të marrin kuptime të reja ashtu siç edhe bëjnë. Kjo sigurisht ka ndodhur me konceptin e maskulinitetit hegjemonik, i cili është trajtuar në fusha si edukimi dhe psikoterapia deri te parandalimi i dhunës dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Disa nga paqartësitë

që i bezdisin kritikët burojnë nga përdorimet e ndryshme që ka gjetur koncepti dhe mënyrat si ka qenë i lakuar si përgjigje në kontekste të reja.

Ky është ndoshta një problem i përgjithshëm në raport me konceptualizimin në shkencat shoqërore dhe shkencat humane. Përderisa formulimi teorik gjen zbatim në mjedise të tjera dhe në ato mjedise, koncepti duhet të ndryshojë - dhe mund të ndryshojë në drejtime të ndryshme në mjedise të ndryshme. Kështu, një koncept specifik mund të shndërrohet në një koncept të përgjithshëm mbi mënyrën e të folurit, një stil analize ose një figurë karakteristike në argumentim. Nuk ka asgjë të keqe me këtë proces në vetvete - është një mënyrë e zakonshme që dija zhvillohet në shkencat shoqërore dhe humane. Por kjo do të thotë se gjithashtu që përdorimet të reja duhet të jenë të hapura ndaj kritikës dhe që mund të kenë mungesë të substancës ose arsyes që gjindet tek origjinalja.

Kështu, ndërsa ne mirëpresim shumicën e aplikimeve dhe modifikimeve të konceptit të maskulinitetit hegjonik si kontribut në kuptimin e dinamikës gjinore, ne refuzojmë ato përdorime që nënkuptojnë një lloj karakteri fiks ose një grumbullim të tipareve toksike. Këto përdorime nuk janë të parëndësishme - ato po përipiqen të emërtojnë çështje të rëndësishme për gjininë, si p.sh. vazhdimësia e dhunës ose pasojat e dominimit. Por ato e bëjnë këtë në një mënyrë që bie ndesh me analizën e hegjemonisë në marrëdhëniet gjinore dhe për këtë arsye është në kundërshtim (jo thjesht një ndryshim mbi) me artikujt fillestare dhe zhvillimet kryesore të këtij koncepti.

Një analizë e renovuar e maskuliniteteve hegjemonike, të llojit siç është sugjeruar më sipër, ka një rëndësi të madhe në kontekstin e tanishëm të politikave gjinore. Në vendet e pasura të metropolit global, zhvendosja nga neoliberalizmi (agjenda e tregut radikal e formuluar në vitet 1970) ndaj neokonservatizmit (duke shtuar thirrjet populiste të bazuar në fe, etnocentrizëm dhe siguri kombëtare) e ka bërë reagimin gjinor një çështje të rëndësishme politike dhe kulturore. Në vendet në zhvillim, proceset e globalizimit kanë hapur rendet gjinore rajonale dhe lokale ndaj presioneve të reja për transformim dhe gjithashtu kanë hapur rrugën për koalicionet e reja midis grupeve të burrave të fuqishëm. Në arenat globale të korporatave transnacionale, mediave dhe sistemeve të sigurisë, praktika të reja të hegjemonisë farkëtohen. Krijimi dhe kontestimi i hegjemonisë në ndryshimin historik të rendit gjinor është një proces me rëndësi të madhe për të cilat ne vazhdojmë të kemi nevojë për mjete konceptuale.

Shënim për autoren/autorin:

R. W. Connell (Raewyn Connell) është profesore universiteti në Universitetin e Sidneit dhe autore ose bashkëautore e 18 librave, duke përfshirë: Klasa sunduese në kulturë sunduese, Bërja e ndryshimit, Gjinia dhe pushteti, Shkollat dhe drejtësia sociale, Maskulinitetet, Burrat dhe djemtë, dhe së fundmi, Gjinia. Ajo është bashkëredaktore e Manualit të studimeve mbi burrat dhe maskulinitetet si dhe redaktore e Burrat, djemtë dhe barazia gjinore. Ajo është një kontribuese në revista kërkimore në fushat e sociologjisë, arsimit, shkencave politike, studimeve gjinore dhe fusha të ngjashme. Hulumtimi i saj aktual ka të bëjë me teorinë sociale, ndryshimet e maskuliniteteve, neoliberalizmin, globalizimin dhe intelektualët.

James W. Messerschmidt është profesor i sociologjisë në Departamentin e Kriminalistikës në Universitetin e Maine-it jugor. Ai është autor i shumë artikujve, kapitujve dhe librave mbi gjininë dhe krimin, duke përfshirë Kapitalizmin, Patriarkatin dhe Krimin, Maskulinitetet dhe Krimin, Krimin

si veprim strukturor, Nëntë jetë, dhe së fundmi, Mish dhe Gjak. Aktualisht, ai është duke punuar në tre projekte kërkimore që përfshijnë dallimin seks-gjini dhe teorinë kriminalistike, Trupat e gjinëzuar dhe dhuna ndërpersonale, maskulinitetet globale, krimet politike dhe shteti.

Referencat

Altman, D. 1972. Homoseksual: Shtypja dhe çlirimi. Sidnej, Australi: Angus dhe Robertson.

Archer, L. 2001. Vëllezërit myslimanë, djemtë zezakë, aziatikët tradicionalë: konstruktet e racës, religjionit dhe maskulinitetit sipas të rinjëve myslimanë britanikë, *Feminizmi & Psikologjia* 11 (1): 79-105.

Baca Zinn, M. 1982. Burrat meksikanë dhe maskuliniteti. *Revista e Studimeve Etnike* 10 (2): 29-44.
Barrett, F. J. 1996. Ndërtimi organizativ i maskulinitetit hegjemonik: Rasti i marinës së Sh.B.A. *Gjinia, puna dhe organizimi* 3 (3): 129-42.

Belton, R. J. 1995. Bomba me fjongo: Imazhi i gruas në artin surrealist maskilist. Calgary, Kanada: University of Calgary Press.

Berg, L. D. 1994. Maskuliniteti, vendi dhe një diskurs binar i "teorisë" dhe "hulumtimit empirik" në gjeografinë njerëzore të Aotearoa/Zelandës së Re. *Gjinia, Vendi dhe Kultura* 1 (2): 245-60.

Bird, S. R. 1996. Mirë se vini në klubin e burrave: Homosocialiteti dhe ruajtja e maskulinitetit hegjemonik. *Gjinia & Shoqëria* 10 (2): 120-32.

Bourdieu, P. 2001. Dominimi maskilist. Stanford, CA: Shtypi i Universitetit të Stanford.

Brannon, R. 1976. Roli i seksit maskilist: Projekti i burrërisë së kulturës sonë dhe çfarë është bërë për ne së fundmi.

Në shumicën e dyzet e nëntë përqindëshit: Roli i seksit maskilist, redaktuar nga D. S. David dhe R. Brannon. leximi, MA: Addington-eesley.

Brod, H. 1987. Bërja e maskulinitetit: Studimet për burrat e rinjë. Boston: Allen dhe Unwin.

—. 1994. Disa mendime mbi disa histori të disa maskuliniteteve: hebrenj dhe të tjerë. nga Teorizimi i maskulinitetit, redaktuar nga D. S. David dhe R. Brannon. Thousand Oaks, CA: Sage.

Broker, M. 1976. "Unë mund të jem queer, por të paktën jam burrë": Hegjemonia maskuliste dhe gjinia e atribuar kundrejt gjinisë së arritur. Nga Ndarjet seksuale dhe shoqëria, redaktuar nga D. Leonard Barker dhe S. Allen. Londër: Tavistock.

Broën, D. 1999. Bashkëfajësia dhe riprodhimi në mësimdhënien e edukimit fizik. *Sporti, Arsimi dhe Shoqëria* 4 (2): 143-59.

Bufkin, J. L. 1999. Krimi i paragjykit si sjellje gjinore. *Drejtësia Sociale* 26 (1): 155-76.

Burgess, I., A. Edwards dhe J. Skinner. 2003. Kultura e futbollit në një mjedis shkolle australiane: Konstruktimi i identitetit mashkullor. *Sporti, Arsimi dhe Shoqëria* 8 (2): 199-212.

Campbell, H. 2000. Fallusi i qelqit: Maskuliniteti publik dhe pija në zonat rurale të Zelandës së Re. *Sociologjia rurale* 65 (4): 562-81.

Carrigan, T., R. ë. Connell dhe J. Lee. 1985. Drejt një sociologjie të re të maskulinitetit. *Teoria dhe Shoqëria* 14 (5): 551-604.

Cavender, G. 1999. Zbulimi i maskulinitetit. Mbi turbullimin: Konstruktet kulturore të krimit, devijimit dhe kontrollit, redaktuar nga J. Ferrell dhe N. ëebsdale. Nju Jork: Aldine de Gruyter.

Cheng, C. 1996. "Ne zgjedhim të mos konkurrojmë": Diskursi i "meritës" në procesin e përzgjedhjes dhe burrat aziatikë dhe ata amerikano-aziatikë dhe maskuliniteti i tyre. Në: maskulinitetet në organizata, e redaktuar nga C. Cheng. Thousand Oaks, CA: Sage.

Cockburn, C. 1983. Vëllezërit: Dominimi maskulist dhe ndryshimi teknologjik. Londër: Plutoni.

—. 1991. Në rrugën e burrave: Rezistenca e burrave ndaj barazisë seksuale në organizata. Londër: Macmillan.

Collier, R. 1998. Maskulinitetet, krimi dhe kriminologjia: Burrat, heteroseksualiteti dhe të kriminalizuarit e tjerë. Londër: Sage.

Collinson, D. dhe J. Hearn. 1994. Emërtimi i burrave si burra: Implikimet për punën, organizimin dhe menaxhmentin. *Gjinia, puna dhe organizimi* 1 (1): 2-22.

Collinson, D., D. Knights dhe M. Collinson. 1990. Menaxhimi i diskriminimit. Londër: Routledge.

Connell, R. W. 1977. Klasa sunduese, kultura sunduese. Kembrixh, MB: Shtypi i universitetit të Kembrixhit.

—. 1982. Klasa, patriarkati dhe teoria e praktikës e Sartrit. *Teoria dhe Shoqëria* 11:305-20.

—. 1983. Cila është rruga tjetër? Ese mbi seksin, klasën dhe kulturën. Sidnej, Australi: Allen dhe Unwin.

—. 1987. *Gjinia dhe pushteti*. Sydney, Australi: Allen dhe Unwin.

—. 1990. Një njeri i hekurt: Trupi dhe disa kontradikta të maskulinitetit hegjemonist. Nga *Sporti, burrat dhe renditja gjinore*, redaktuar nga M. Messner dhe D. Sabo. Champaign, IL: Librat e Kinetikës Njerëzore.

—. 1995. *Maskulinitetet*. Kembrixh, MB: Shtypi Polity.

—. 1998. *Maskulinitetet dhe globalizimi*. Burrat dhe maskulinitetet 1 (1): 3-23.

—. 2002. Gjinia. Kembrixh, MB: Polity.

—. 2003. Maskulinitetet, ndryshimi dhe konflikti në shoqërinë globale: Të menduarit për të ardhmen e studimeve të burrave. *Gazeta për studimet e burrave* 11 (3): 249-66.

—. 2005. Globalizimi, imperializmi dhe maskulinitetet. Në *Manualin e Studimeve mbi Burrat dhe maskulinitetin*, redaktuar nga M. S. Kimmel, J. Hearn dhe R. W. Connell. Thousand Oaks, CA: Sage.

Connell, R. W., D. J. Ashenden, S. Kessler dhe G. ë. Dowsett. 1982. Duke bërë dallimin: Shkollat, familjet dhe ndarja sociale. Sidnej, Australi: Allen dhe Unwin.

Connell, R. W. dhe J. ëood. 2005. Globalizimi dhe maskulinitetet e biznesit. *Burrat dhe maskulinitetet* 7 (4): 347-64.

Consalvo, M. 2003. Përbindëshat fqinjë: Ndërtimet mediatike të djemve dhe maskuliniteti. *Studimet feministe mediatike* 3 (1): 27-46.

Dasgupta, R. 2000. Performimi i maskuliniteteve? "Pagëmarrësi" në punë dhe lojë. *Studime japoneze* 20 (2): 189-200.

Davis, A. 1983. Gratë, raca dhe klasa. Nju Jork: Vintage.

Demetriou, D. Z. 2001. Koncepti i Connell-it për maskulinitetin hegjemonik: Një kritikë. *Teoria dhe Shoqëria* 30 (3): 337-61.

Denborough, D. 1996. Hap pas hapi: Zhvillimi i mënyrave të respektueshme dhe efektive për të punuar me burrat e rinjë për të reduktuar dhunën. Nga *Mënyrat e të qenurit burrë*, redaktuar nga C. McLean, M. Carey dhe C. ëhite. Boulder, CO: ëestvieë.

Dinges, M., E. Rëndal dhe D. Bauer. 2004. Program. Programi për konferencën për maskulinitetin hegjemonik Shtutgart, Gjermani, 24-26 qershor.

Donaldson, M. 1991. Koha e jetës sonë: Punë dhe dashuri në klasën punëtore. Sydney, Australi: Allen dhe Unwin.

—. 1993. Çfarë është maskuliniteti hegjemonist? *Teoria dhe Shoqëria* 22:643-57.

Donaldson, M. dhe S. Poynting. 2004. Koha e jetës së tyre: Koha, puna dhe koha e lirë në jetën e përditshme të burrave të klasës sunduese. Nga *Australia sundimtare: Pushteti, privilegji dhe politika e klasës së re sunduese*, redaktuar nga N. Hollier. Melburn: Studiuës Australian.

Eisenstein, Z. R. 1979. Patriarkati kapitaliste dhe rasti i feminizmin socialist. Nju Jork: Shtypi Rishikimi Mujor.

Ferguson, H. 2001. Burrat dhe maskulinitetet në Irlandën postmoderne. Në *botën e një njeriu? Ndryshimi i praktikave të burrave në një botë të globalizuar*, redaktuar nga B. Pease dhe K. Pringle. Londër: Zed Books.

- Frojd, Sigmund. [1917] 1955. Nga historia e një neuroze fëmijërore. Punime të plota psikologjike. Standard ed., Vol. 17. Londër: Hogarth.
- Friedman, R. M. dhe L. Lerner. 1986. Drejt një psikologjie të re të burrave: Performanca Psikoanalitike dhe Sociale. Numri special, Rishikimi Psikoanalitik 73 (4).
- Gerschick, T. J. dhe A. S. Miller. 1994. Identitetet gjinore në udhëkryqin e maskulinitetit dhe paaftësisë fizike. Maskulinitetet 2 (1): 34-55.
- Goode, W. 1982. Pse burrat rezistojnë. Nga Rimendimi i familjes: Disa pyetje feministe, redaktuar nga B. Thorne dhe M. Yalom. Nju Jork: Longman.
- Gutmann, M. C. 1996. Kuptimi i maços: Të jesh burrë në Mexico City. Berkeley: Shtypi i Universitetit të Kalifornisë.
- Hacker, H. M. 1957. Barrat e reja të maskulinitetit. Martesa dhe Jetesa Familjare 19 (3): 227-33.
- Halberstam, J. 1998. Maskuliniteti femëror. Durham, NC: Shtypi në Universitetin Duke
- Hanke, R. 1992. Ridizajnimi i burrave: Maskuliniteti hegjemonik në tranzicion. Nga Burrat, maskuliniteti dhe media, redaktuar nga S. Craig. Neëbury Park, CA: Sage.
- Hawkesworth, M. 1997. Konfuzioni gjinor. Shenjat: Gazeta e grave ne kulture dhe shoqeri 22 (3):649-85.
- Hearn, J. 1996. A është maskuliniteti i vdekur? Një kritikë e konceptit të maskulinitetit/maskuliniteteve. Nga Kuptimi i maskuliniteteve: Marrëdhëniet shoqërore dhe arena kulturore, redaktuar nga M. Mac an Ghail. Buckingham, MB: Shtypi i Open University.
- . 2004. Nga maskuliniteti hegjemonik në hegjemoninë e burrave. Teoria Feministe 5 (1): 49-72.
- Herdt, G. H. 1981. Gardianët e flautave: Idiomat e maskulinitetit. Nju Jork: McGraë-Hill.
- Higate, P. R. 2003. Maskulinitetet ushtarake: Identiteti dhe shteti. Londër: Praeger.
- Hochschild, A. 1989. Ndërimi i dytë: Prindërit që punojnë dhe revolucioni në shtëpi. Nju Jork: Viking.
- Holter, Ø. G. 1997. Gjinia, patriarkalizmi dhe kapitalizmi: Një analizë e formave sociale. Oslo, Norvegji: Universiteti i Olsos.
- . 2003. A mund ta arrijnë meshkujt? Burrat dhe barazia gjinore - Përvoja nordike. Kopenhagë, Danimarkë: Këshilli i Ministrave Nordik.
- hooks, b. 1984. Teoria feministe: Nga periferia në qendër. Boston: South End.

Hooper, C. 1998. Praktikrat maskuliniste dhe politikrat gjinore: Veprimi i maskuliniteteve të shumta në marrëdhëniet ndërkombëtare. Çështja e "burrit" në marrëdhëniet ndërkombëtare, redaktuar nga M. Zalewski dhe J. Parpart. Boulder, CO: Westview.

—. 2000. Maskulinitetet në tranzicion: Rasti i globalizimit. Ristrukturimi gjinor dhe global, redaktuar nga M. H. Marchand dhe A. S. Runyan. Londër: Routledge.

—. 2001. Manly thekson: Maskulinitetet, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikrat gjinore. Nju Jork: Shtypi i Universitetit të Kolumbisë.

Hunt, P. 1980. Gjinia dhe vetëdija klasore. Londër: Macmillan.

Ishii-Kuntz, M. 2003. Balancimi i atësisë dhe punës: Shfaqja e maskuliniteteve të ndryshme në Japoninë bashkëkohore. Nga Burrat dhe maskulinitetet në Japoninë bashkëkohore, redaktuar nga J. E. Roberson dhe N. Suzuki. Londër: Routledge Curzon.

Jansen, S. C. dhe D. Sabo. 1994. Metafora sport-luftë: Maskuliniteti hegjemonik, lufta e gjirit Persik dhe rendi i ri botëror. Revista "Sociologjia e Sportit" 1 (1): 1-17.

Jefferson, T. 1994. Teorizimi i subjektivitetit maskulist. Në: Vetëm djemtë duke bërë biznes? Burrat, maskulinitetet dhe krimi, redaktuar nga T. Newburn dhe E. A. Stanko. Londër: Routledge.

—. 2002. Nënshtrimi i maskuliniteti hegjemonik. Kriminologjia teorike 6 (1): 63-88.

Kessler, S. J., D. J. Ashenden, R. ë. Connell dhe G. W. Dowsett. 1982. Ockers dhe disko-maniakët. Sydney, Australi: Qendra e arsimit të qytetit të brendshëm.

Kimmel, M. S. 1987. Rimendimi i "maskulinitetit": Drejtime të reja në kërkime. Nga Të ndryshuarit e burrave: Drejtime të reja në kërkimin mbi burrat dhe maskulinitetin, redaktuar nga M. S. Kimmel. Neëbury Park, CA: Sage.

—. 2005. Globalizimi dhe përmbajtja e tij maskiliste: Ekonomia morale dhe politike gjinore e terrorizmit. Nga Manuali i studimeve mbi burrat dhe maskulinitetet, redaktuar nga M. S. Kimmel, J. Hearn dhe R. W. Connell. Thousand Oaks, CA: Sage.

Kimmel, M. S. dhe M. Mahler. 2003. Maskuliniteti i adoleshentëve, homofobia dhe dhuna: Të shtëna të rastësishme në shkollë, 1982-2001. Revista "Shkencëtari amerikan i sjelljeve" 46 (10): 1439-58.

Kupers, T. A. 1993. Rishikimi i jetës së burrave: Gjinia, intimiteti dhe fuqia. Nju Jork: Guilford.

Lea, S. dhe T. Auburn. 2001. Konstrukti social i përdhunimit në fjalimin e një përdhunuesi të dënuar. Feminizmi & Psikologjia 11 (1): 11-33.

Light, R. dhe D. Kirk. 2000. Rugby i shkollës së mesme, trupi dhe riprodhimi i maskulinitetit hegjemonik. Sporti, Arsimit dhe Shoqëria 5 (2): 163-76.

Mac an Ghail, M. 1994. Krijimi i burrave: Maskulinitetet, seksualitetet dhe shkollimi. Buckingham, MB: Open University Press.

MacInnes, J. 1998. Fundi i maskulinitetit: Konfuzioni i gjenezës seksuale dhe diferenca seksuale në shoqërinë moderne. Buckingham, MB: Open University Press.

Martin, P. Y. 1998. Pse një burrë nuk mund të jetë më shumë si një grua? Reflektime mbi maskulinitetet e Connell-it. Gjinia dhe Shoqëria 12 (4): 472-74.

—. 2001. "Mobilizimi i maskuliniteteve": Përvojat e grave të burrave në punë. Organizatat 8 (4): 587-618.

Martino, W. 1995. Djemtë dhe shkrim-leximi: Eksplorimi i ndërtimit të maskuliniteteve hegjemonike dhe formimi i kapaciteteve të shkrim-leximit për djemtë në klasën e anglishtes. Anglishtja në Australi 112:11-24.

McMahon, A. 1993. Leximet mashkullore të teorisë femine: Psikologjizimi i politikës seksuale në letërsinë mashkullore. Teoria dhe Shoqëria 22 (5): 675-95.

Messerschmidt, J. W. 1993. Maskulinitetet dhe krimi: Kritika dhe rikonceptimi i teorisë. Lanham, MD: Rowman & Littlefield.

—. 1995. Menaxhimi për të vrarë: Maskulinitetet dhe shpërthimi i anijes kozmike Challenger. Maskulinitetet 3 (4): 1-22.

—. 1997. Krimi si veprim i strukturuar: Gjinia, raca, klasa dhe krimi në zhvillim e sipër. Thousand Oaks, CA: Sage.

—. 2000. Nëntë jetë: Maskuliniteti i adoleshentëve, trupi dhe dhuna. Boulder, CO: Westview.

—. 2004. Mishi dhe gjaku: Diversiteti gjinor dhe dhuna tek adoleshentët. Lanham, MD: Rowman & Littlefield.

—. 2005. Burrat, maskulinitetet dhe krimi. Nga Manuali i studimeve mbi burrat dhe maskulinitetin, redaktuar nga M. S. Kimmel, J. Hearn dhe R. W. Connell. Thousand Oaks, CA: Sage.

Messner, M. A. 1992. Fuqia në lojë: Sporti dhe problemi i maskulinitetit. Boston: Beacon.

—. 1997. Politika e maskuliniteteve: Burrat në lëvizje. Thousand Oaks, CA: Sage.

—. 2002. Marrja e terrenit: Gratë, burrat dhe sporti. Minneapolis: Shtypi i Universitetit të Minesotës.

Messner, M. A., dhe D. Sabo, eds. 1990. Sporti, burrat dhe rendi gjinor: perspektiva kritike femine. Champaign, IL: Librat e Kinetikës Njerëzore.

Meuser, M. 2001. "Kjo në të vërtetë nuk do të thotë se ajo po mban një kamxhik": Transformimi i rendit gjinor dhe modernizimi kontradiktor i maskulinitetit. Diskurs 1:44-50.

—. 2003. Maskulinitetet e modernizuara? Vazhdimësia, sfidat dhe ndryshimet në jetën e burrave. Nga Mes burrave: Gdhendja e maskuliniteteve, redaktuar nga S. Ervø dhe T. Johansson. Aldershot, MB: Ashgate.

Meuser, M. dhe C. Behnke. 1998. Një mijë e një burri? Modelet e maskulinitetit dhe integrimi social e strukturor. Kontradiktat 67:7-25.

Mieli, M. 1980. Homoseksualiteti dhe çlirimi: Elemente të një kritike homoseksuale, përkthyer nga D. Fernbach. Londër: Shtypi i burrave gej.

Mittelman, J. H. 2004. Ç'globalizim? Vorbulla e dijes dhe ideologjisë. Londër: Routledge.

Morin, S. F. dhe E. M. Garfinkle. 1978. Homofobia maskuliste. Revista e Çështjeve sociale 34 (1): 29-47.

Morrell, R. 1998. Prej djemve dhe burrave: Maskuliniteti dhe gjinia në studimet e Afrikës së Jugut. Gazeta e Studimeve të Afrikës Jugore 24 (4): 605-30.

Morrell, R. dhe S. Swart. 2005. Burrat në Botën e Tretë: Perspektiva postkolonialiste mbi maskulinitetin. Nga Manuali i studimeve mbi burrat dhe maskulinitetin, redaktuar nga M. S. Kimmel, J. Hearn dhe R. ë. Connell. Thousand Oaks, CA: Sage.

Morris, C. dhe N. Evans. 2001. "Djathëbërëset janë gjithmonë gra": Paraqitja gjinore e jetës në fermë në shtypin bujqësor. Gjinia, vendi dhe kultura 8 (4): 375-90.

Mosher, D. L. dhe S. S. Tomkins. 1988. Shkrimi mbi burrin maço: Socializimi dhe kulturimi hiper-maskulist. Gazeta e Hulumtimeve mbi seksin 25 (1): 60-84.

Namaste, V. K. 2000. Jetët e padukshme: Fshirja e njerëzve transeksualë dhe transgjinorë. Çikago: Shtypi i Universitetit të Çikagos.

Newburn, T., dhe E. A. Stanko. 1994. Vetëm djem që bëjnë biznes? Burrat, maskulinitetet dhe krimi. Nju Jork: Routledge.

Pease, B., dhe K. Pringle, eds. 2001. Bota e burrave? Ndryshimi i praktikave të burrave në një botë të globalizuar. Londër: Zed Books.

Petersen, A. 1998. Demaskimi i maskulinitetit: "Burrat" dhe "identiteti" në një moshë skeptike. Londër: Sage.

—. 2003. Kërkim mbi burrat dhe maskulinitetin: Disa implikime të teorisë së fundit për punën e ardhshme. Burrat dhe maskulinitetet 6 (1): 54-69.

Pleck, J. 1981. Miti i maskulinitetit. Kembrixh, MA: MIT Press.

Plummer, K., ed. 1981. Krijimi i homoseksualit modern. Londër: Macmillan.

Poynting, S., G. Noble dhe P. Tabar. 2003. "Kryqëzimet" e maskulinitetit dhe përkatësisë etnike: Një studim i të rinjëve burra libanez në Sidnein Perëndimor. Dorëshkrim i pabotuar, Universiteti i Sidnejit Perëndimor

Roberts, P. 1993. Kontrolli social dhe censurimi(et) e seksit. *Krimi, Ligji dhe Ndryshimi Social* 19 (2): 171-86.

Roper, M. 1994. Maskuliniteti dhe burri i organizatës britanike që nga viti 1945. Oxford, MB: Shtypi nga Universiteti i Oksfordi

Rubin, H. 2003. Burrat e vetë-bërë: Identiteti dhe mishërimi midis burrave transeksualë. Nashville, TN: Shtypi i Universitetit Vanderbilt.

Sabo, D., dhe D. F. Gordon, eds. 1995. Shëndeti dhe sëmundja e burrave: Gjinia, pushteti dhe trupi. Thousand Oaks, CA: Sage.

Sabo, D. dhe S. C. Jansen. 1992. Imazhet e burrave në mediat sportive: Riprodhimi social i rendit gjinor. Në *Burrat, maskuliniteti dhe media*, redaktuar nga S. Craig. Neëbury Park, CA: Sage.

Salisbury, J. dhe D. Jackson. 1996. Sfidimi i vlerave maço: Mënyra praktike për të punuar me adoleshentët djem. Uashington, DC: Falmer.

Schäalbe, M. 1992. Supremacia maskiliste dhe ngushtimi i vetes morale. *Revista e Sociologjisë në Berkeley* 37:29-54.

Scott, J. W. 1997. Komentim i "gjinisë konfuze" të Hawkesworth. *Shenjat: Gazeta e grave në kulturë dhe shoqëri* 22 (3): 697-702.

Segal, L. 1990. Xhirim i ngadalësuar: Ndryshimi i maskuliniteteve, ndryshimi i burrave. Londër: Virago.

Skelton, A. 1993. Të bërit mësues i edukimit fizik: Kultura informale e nxënësve dhe ndërtimi i maskulinitetit hegjemonist. *Gjinia dhe edukimi* 5 (3): 289-303.

Snodgrass, J., ed. 1977. Për burrat kundër seksizmit: Një libër leximesh. Albion, CA: Times Change Press.

Stoller, R. J. 1968. Seksi dhe gjinia: Mbi zhvillimin e maskulinitetit dhe feminitetit. Nju Jork: Shtëpia e shkencës.

Taga, F. 2003. Rimendimi i socializimit maskulist: Historitë jetësore të rinisë maskiliste japoneze. Në *maskulinitetin aziatik*, redaktuar nga K. Louie dhe M. Loë. Londër: Routledge Curzon.

Thorne, B. 1993. Shfaqje gjinore. New Brunswick, NJ: Shtypi i Rutgers University.

Thornton, M. 1989. Maskuliniteti hegjemonik dhe akademia. *Revista Ndërkombëtare e Sociologjisë ligjore* 17:115-30.

Tolson, A. 1977. Kufijtë e maskulinitetit. Londër: Tavistock.

Tomsen, S. 2002. Urrejtja, vrasja dhe nderi i burrit: Vrasjet kundër homoseksualëve në Uellsin e Ri Jugor, 1980-2000. Vëllimi. 43. Canberra: Instituti Australian i Kriminologjisë.

Valdes, T. dhe J. Olavarría. 1998. Të jesh burrë në Santiago të Kilit: Pavarësisht gjithçkaje, i njëjti model. Në maskulinitetet dhe barazia gjinore në Amerikën Latine, redaktuar nga T. Valdés dhe J. Olavarría. Santiago, Kili: FLACSO/UNFPA.

Wajcman, J. 1999. Menaxhimi si burrë: Gratë dhe burrat në menaxhimin e korporatës. Sidnej Australi: Allen dhe Unwin.

Walby, S. 1997. Transformimet gjinore. Londër: Routledge.

Warren, S. 1997. Kush mendojnë se janë këta djem? Një hetim në kontruktet e maskuliniteteve në një klasë fillore. Gazeta nderkombetare e Edukimit Gjithëperfishires 1 (2): 207-22.

Wetherell, M. dhe N. Edley. 1999. Negocimi i maskulinitetit hegjemonik: Pozicionet imagjinare dhe praktikat psiko-diskursive. Feminizmi dhe Psikologjia 9 (3): 335-56.

Whitehead, S. M. 1998. Maskuliniteti hegjemonik i rivizituar. Gjinia, puna dhe organizimi 6 (1): 58-62.

—. 2002. Burrat dhe maskulinitetet: Temat kryesore dhe drejtimet e reja. Kembrixh, MB: Polity.

Willis, P. 1977. Të mësuarit për të punuar: Si fëmijët e klasës punëtore marrin punë të klasës punëtore. Farnborough, MB: Shtëpia botuese Saxon.

Zaretsky, E. 1975. Supremacia maskuliste dhe e pavetëdijshmja. Revolucioni Socialist 4:7-55.



KOLEKTIVI PËR MENDIM DHE VEPRIM
FEMINIST

Prishtinë, dhjetor 2022